

# **RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

**RISHIKIM I PLANIT TE PERGJITHSHEM VENDOR NJESIA  
STRUKTUREORE KZ\_UB\_AR3\_14/315, KZ\_UB\_IS2\_14/316,  
KZ\_UB\_AS2\_14/196 DHE KZ\_UB\_A2\_14/427.**

**BASHKIA KAMEZ**

## Tabela Permbledhese

1.	HYRJE	3
2.	LEGJISLACIONI DHE PROCEDURAT MBROJTJESE MJEDISORE	3
2.1	LEGJISLACIONI MJEDISOR	3
2.2	LEGJISLACIONI PER MENAXHIMIN E MBETJEVE	7
2.3	LEGJISLACIONI PER PLANIFIKIMIN TERRITORIAL TRASHEGIMINE KULTURORE DHE GJETJET RASTESISHME	8
3.	TE PERGJITHSHME MBI PERSHKRIMIN E PROJEKTIT	9
4.	PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONEN E PROJEKTIT	21
4.1	PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES	21
4.2	MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK	29
4.3	TRASHEGIMIA HISTORIKE DHE KULTURORE	29
4.4	KLIMA	30
4.5	GJELOGJIA DHE GJEOMORFOLOGJIA	35
4.6	INFORMACION MBI PRANINE E BURIMEVE UJORE	37
4.7	INFORMACIONE PER ELEMENTE TE TJERE TE MJEDISIT	40
5.	INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME,NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT	45
5.1	METODOLOGJIA PER IDENTIFIKIMIN DHE ANALIZEN E NDIKIMEVE	45
6.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE POTENCIALE MJEDISORE DHE SOCIALE	47
6.1	NDIKIMET NE MJEDIS	47
6.2	NDIKIMET SOCIALE	56
7.	INFORMACION MBI SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS	58
7.1	SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA	58
7.2	SHKARKIMET E GAZRAVE DHE PLUHRAVE	58
7.3	ZHURMAT DHE VIBRIMET	59
7.4	PRODHIMI I MBETJEVE	59
8.	KOHEZGJATJA E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA	60
9.	MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	60
9.1	MARRËVESHJET INSTITUCIONALE	60
9.2	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	61
9.3	MEKANIZMI I ANKESAVE	61
9.4	MASAT PER SHMANGIEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NE MJEDIS	62
10.	NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR	64
11.	PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	64

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	3 of 65
--	----------------------	------------	-------	---------

## 1. HYRJE

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar ne kuader te projektit **"RISHIKIM I PLANIT TE PERGJITHSHEM VENDOR NJESIA STRUKTUREORE KZ\_UB\_AR3\_14/315, KZ\_UB\_IS2\_14/316, KZ\_UB\_AS2\_14/196 DHE KZ\_UB\_A2\_14/427"**.

Në nenin 7 të Ligjit Nr. 10440 date 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" është dhënë në menyre të qarte se cilat projekte i nënshtrohen vlerësimit e ndikimit në mjedis, ku thuhet se: "Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit".

Sipas Ligjit të sipërcituar "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", (ndryshuar me Ligjin Nr. 12/2015 për një ndryshim në Ligjin Nr. 10440, Datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis") dhe Vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" arrijmë në konkluzionin se: aktiviteti që propozohet duhet ti nënshtrohet **Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Shtojca II: Pika 10, germa b -Prodhime infrastrukturore: Projekte për zhvillime urbane duke përfshire edhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjet per makinat).**

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti është në përputhje me Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore".

Raporti permban dy pjesë: Raportin teknik dhe Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis dhe janë pjesë e dokumentacionit të nevojshëm ne zbatim të procedures paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e lart-përmendur.

Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në **raportin e Rishikimit te Planit te Pergjithshem Vendor Hartuar nga Sektori i Planifikimit te Territorit, DPZHT Bashkia Kamez.** Raporti ka për qëllim të jape konsideratat mbi impaktet mjedisore të projektit të propozuar në mënyrë që të orientojë institucionet, apo organet vendim marrëse në dhënien e miratimit të kryerjes se aktivitetit.

Raporti ka për qëllim identifikimin e efekteve negative dhe pozitive, si dhe të propozojë masat zbutëse duke marrë në konsideratë interesat ekonomike të investitorit, si dhe përdorimin racional të burimeve natyrore dhe koordinimin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është që të:

1. të identifikojë ndikimet e mundshme mjedisore në zonën në studim gjatë punimeve
2. të identifikojë ndikimet e mundshme socio-ekonomike në zonën në studim gjatë dhe pas vënies në jetë të projektit
3. të propozojë marrjen e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të krijuara në mjedis nga vënia në jetë e këtij projekti;
4. të propozojë masat e nevojshme rehabilituese përpara vënies në shfrytëzim të projektit në vlerësim.
5. të sigurohet që konsideratat mjedisore të trajtohen në mënyrë eksplicite dhe të përfshihen në procesin e vendimmarrjes.

## 2. LEGJISLACIONI DHE PROCEDURAT MBROJTESE MJEDISORE

### 2.1 LEGJISLACIONI MJEDISOR

Në Nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon (1) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, dhe (2) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm,„. Nisur nga kompleksiteti i tyre, çështjet mjedisore synohet të përfshihen në të gjitha Planet Lokale e Rajonale të Veprimit, Strategjitë dhe Programet Sektoriale dhe Strategjitë Kombëtare.

Ligji mjedisor kryesor është Ligji Nr. 10431, datë 9 Qershor 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Ky Ligj përcakton politikat kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	4 of 65
--	----------------------	------------	-------	---------

vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin dhe vlerësimin strategjik mjedisor, kërkesat për dhënien e lejeve veprimtarive që ndikojnë mbi mjedisin, parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit, normat dhe standartet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, detyrat e organëve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, rolin e publikut dhe sanksionet e përcaktuara në rast të shkeljes të ligjit. Ligji përcakton objektivat e mëposhtme të mbrojtjes së mjedisit:

- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrjen e publikut;
- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dhe
- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Ligji Nr. 10440 datë 7/07/2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të projekteve ose veprimtarive mbi mjedisin. Ligji përcakton hapat e nevojshme për zbatimin e procedurave të VNM: dorëzimin e kërkesës, shqyrtimin paraprak, kriteret e përzgjedhjes dhe klasifikimit, seancat dëgjimore dhe konsultimet publike, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organeve të tjera. Ligji përcakton gjithashtu listën e veprimtarive që duhet të jenë objekt i procesit të Thelluar dhe atij Paraprake të VNM.

Ligji i lart-përmendur nënvizon se qëllimi i Vlerësimit Mjedisor është të sigurojë: Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendim marrjeje gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve në mjedis në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të. Procesi i vlerësimit duhet të jetë i përgjithshëm, i integruar, në kohë, i hapur dhe të realizohet në mënyrë të paanshme nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, publikut, si edhe organizatave mjedisore jo fitim prurëse, e zhvilluesve të projekteve si edhe të personave fizikë dhe juridikë të specializuar në këtë fushë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e ndikimit mbi mjedis.

Disa nene të këtij ligji janë ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr. 12/2015 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ndryshime këto që kane hyrë në fuqi më 1 Shtator 2015.

Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Ky ligj përcakton edhe rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Ne baze të Ligjit Nr. 60/2014 shtojca 1, bashkëlidhur Ligjit Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", është ndryshuar.

Tabelat me poshte tregojne Objektivat Kombetare te Cilesise se Ajrit per cdo ndotes, dhe limitet ose vlerat e synuara te Direktives Europiane ne perputhje me dy direktivat e BE: Direktiven 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një ajër më të pastër në Evropë dhe Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, mërkurin, nikelin dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Këto standarde dhe objektiva janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme (Tabela 1, 2 dhe 3).

Tabela 1. Vlerat limite te ndoteseve te ajrit bazuar ne shendetin human

Ndotesi	Perqendrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e lejuara cdo vit	Afati per tu arritur
<b>Lenda Grimcore (PM2.5)</b>	25 µg/m <sup>3</sup> nga 2015 20 µg/m <sup>3</sup> nga 2020			
<b>PM10</b>	50 µg/m <sup>3</sup>	24 ore	35	10 vite nga adoptimi i strategjise
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Diosksidi i Squfurit (SO2)</b>	350 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	24	5 vite nga adoptimi i strategjise
	125 µg/m <sup>3</sup>	24 ore	3	5 vite nga adoptimi i strategjise

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	5 of 65
--	----------------------	------------	-------	---------

<b>Dioksid Azoti (NO<sub>2</sub>)</b>	200 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	18	10 vite nga adoptimi i strategjise
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Plumb (Pb)</b>	0.5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	5 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Monoksid Karboni</b>	10 mg/m <sup>3</sup>	Maksimumi nje mesatare ditore 8 oreshe	n/a	5 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Benzene</b>	5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise

Tabela 2. Vlerat e synuara (target) te ndoteseve te ajrit

Ndotsi	Perqendrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e lejuara cdo vit	Afati per tu arritur
<b>Ozone</b>	120 µg/m <sup>3</sup>	Maksimumi nje mesat. ditore 8 oreshe	25 dite ne vit me mesatare te marre mbi 3 vjet	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Arsenik (As)</b>	6 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Kadmium (Cd)</b>	5 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Nikel (Ni)</b>	20 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Hidrokarburet policiklike aromatike</b>	1 ng/m <sup>3</sup> (shprehur si perqendrim i Benzo(a)piren)	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise

Tabela 3. Nivelet kritike per mbrojtjen e vegjetacionit

Ndotsi	Perqendrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e lejuara cdo vit	Afati per tu arritur
<b>Oksid Sulfuri (SO<sub>2</sub>)</b>	20 µg/m <sup>3</sup>	Viti kalendarik dhe dimri (1 Tetor deri ne 31 Mars)	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Okside Azoti (NO<sub>x</sub>)</b>	30 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise
<b>Ozoni. Vlere e synuar</b>	AOT40 (logarituri nga vlera 1h) 18000 µg/m <sup>3</sup> · h	Maj deri ne Korrik	n/a	10 vite nga adoptimi i strategjise

Përpos sa më lart, përgatitja e kësaj VNM-je është bazuar në legjislacionin e mëposhtëm:

**Ligje:**

Ligji Nr. 81/2017, datë 18.05.2017 "Për Zonat e Mbrojtura".

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ligji Nr. 12/2015, datë 26.2.2015 "Për disa ndryshime në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"

Ligji Nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

Ligji Nr.111/2012, datë 15.12.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	6 of 65
--	-------------------------	------------	-------	---------

Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve,,.

Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".

Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2007 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit"

Ligji Nr. 9791, datë 23.07.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9385 "Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor"

Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor"

Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura.

Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".

Ligji Nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike".

Ligji Nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve"

Ligji Nr.91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"

#### **Vendime të Këshillit të Ministrave:**

V.K.M Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"

V.K.M Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

V.K.M Nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të Lejeve të mjedisit"

V.K.M Nr. 227, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kerkesave dhe të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore".

V.K.M Nr. 177, 06.03.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", i ndryshuar.

V.K.M Nr. 587, datë 7.07.2010 "Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbanë dhe turistike"

V.K.MNr. 994,datë02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin"

V.K.M Nr. 853, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listes se mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera qe ndalohen të importohen me qëllime ruajtje, depozitimi dhe asgjësimi"

V.K.M Nr. 248, datë 24.04.2003 "Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe zbatimin e tyre".

V.K.M Nr. 435, datë 12.09.2002 "Për Miratimin e Normave të Shkarkimeve në Ajër në Republikën e Shqipërisë"

V.K.M Nr. 103, datë 31.03.2002 "Mbi Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë".

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	7 of 65
--	----------------------	------------	-------	---------

### Udhëzime dhe Rregullore:

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Financave Nr. 7938, datë 17.7.2014 'Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së'

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Nr. 8 date 27.11.2007 "Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"

Gjithashtu, Shqipëria është palë e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi Biodiversitetin, Ndryshimet Klimatike, procesin e shkretëtizimit, Specie në rrezik, Mbetjet e dëmshme, Ligjin mbi detin, Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Lagunave.

Gjatë hartimit të këtij raporti VNM-je, janë marrë në konsideratë edhe disa nga Direktivat kryesore të BE-së për mjedisin:

- Direktiva 1999/30/CE date 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit. (Council Directive 1999/30/EC of 22 April 1999 relating to limit values for sulphur dioxide, nitrogen dioxide and oxides of nitrogen, particulate matter and lead in ambient air)
- Direktiva 2000/60/CE datë 23 Tetor 2000 për Kuadrin ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave. (Directive 2000/60/EC of 23 October 2000 of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy).
- Direktiva 2001/42/CE datë 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin. (Directive 2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27 June 2001 on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment).
- Direktiva 2011/92/EU e dates 13 Dhjetor 2011 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve publike apo private (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).
- Direktiva 2008/50/CE datë 21 Maj 2008 Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën". (Directive 2008/50/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe).
- Direktiva 2014/52/EU datë 16 Prill 2014 mbi disa ndryshime në Direktivën 2011/92/EU mbi VNM (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment). (Directive 2014/52/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 amending Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).

## 2.2 LEGJISLACIONI PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE

Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri ka përparuar me miratimin e ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve të reja. Qëllimet dhe afatet e parashikuara nga ligjet dhe strategjitë kombëtare janë në përputhje me kërkesat e BE. Një nga objektivat e rëndësishme të kuadrin ligjor dhe arsyeja kryesore e kësaj qasje nga lart-poshtë është krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorët ndërkombëtarë (në fonde të veçanta të BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.

Ligji baze për menaxhimin e mbetjeve mbetet Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar me Ligjin Nr. 156/2013 "Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 10 463, Datë 22.9.2011"

Ligji ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta. Për këtë qëllim, ai përcakton rregulla për trajtimin mjedisor të mbetjeve të ngurta në çdo fazë: krijimit, grumbullimit, ndarjes, transportit, riciklimit, përpunimit dhe deponimit. Ligji më tej ka për qëllim reduktimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimit të mbetjeve toksike dhe të rrezikshme. Ligji zbatohet nga:

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	8 of 65
--	----------------------	------------	-------	---------

- ✓ VKM Nr. 389, datë 27.6.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave "Për Lendfilllet e Mbetjeve"
- ✓ VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"
- ✓ VKM Nr. 94, datë 14.2.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- ✓ VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- ✓ VKM Nr. 117, datë 13.2.2013 "Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qenuri mbetje".
- ✓ VKM Nr. 177, datë 6 mars 2012 "Për paketimin dhe paketimin e mbetjeve".
- ✓ Urdhër Nr. 893, datë 4.10.2013 "Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura".

Amenduar nga:

- ✓ Ligj Nr. 32/2013 datë 14.2.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- ✓ Ligj Nr. 156/2013 datë 10.10.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"

Këto udhëzime nenvijzojnë nevojën për zbatimin e një hierarkie të menaxhimit të mbetjeve që përfshin parandalimin, riciklimin/ ripërdorimin; trajtimin dhe asgjësimin. Udhëzimet kërkojnë ndarjen e mbeturinave konvencionale nga mbetjeve të rrezikshme dhe në qoftë se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme nuk mund të parandalohet (siç është rasti në objektet e kujdesit shëndetësor); menaxhimi i tij duhet të fokusohet në parandalimin e dëmit ndaj shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, në përputhje me parimet e mëposhtme:

- ✓ Njohja dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e cdo lloji mbetje të rrezikshme të krijuar gjatë ciklit jetësor të saj të plotë.
- ✓ Sigurimi që njerëzit/firmat që merren me trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme janë ndërmarrje me reputacion dhe legjitime, të licencuara nga agjencitë përkatëse rregullatore dhe këto zbatojnë praktikën me të mira të industrisë.
- ✓ Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret e aplikueshme.

### **2.3 LEGJISLACIONI PËR PLANIFIKIMIN TERRITORIAL TRASHËGIMINE KULTURORE DHE GJETJET E RASTESISHME**

Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore si edhe të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e private. Ligji synon të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

Ligji zbatohet nga:

- VKM Nr. 408, datë 13.5.2015. Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"
- VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit".



	Emertimi Dokumentit:	<b>RAPORT VNM</b>	Page:	9 of 65
--	-------------------------	-------------------	-------	---------

Regulation No. 739 date 13.12.2017 amending and supplementing Regulation No. 725 date 2.9.2015 on the organization and functioning of the Territory Development Agency.

VKM Nr. 739, datë 13.12.2017. Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 725, datë 2.9.2015, "Per menyren e organizimit dhe funksionimit te Agjensise se Zhvillimit te Territorit".

VKM Nr. 725, datë 2.9.2015, "Per menyren e organizimit dhe funksionimit te Agjensise se Zhvillimit te Territorit".

Amenduar nga:

Ligji No. 28/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

Ligji Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" është ligji baze që përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me zhvillimet transformuese në territor, ligji përcakton qe: "Në rastet e zhvillimeve të mëdha, si: rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, vepra të tjera, si edhe për çdo transformim të territorit, duke përfshirë projektet minerare, në pronësi shtetërore ose private, përpara marrjes së lejes përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, investitori duhet të marrë miratimin për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, sipas legjislacionit në fuqi".

Nëse, gjatë punimeve, ndeshen gjetje rastësore, punimet ndërpriten menjëherë dhe drejtuesi teknik ose investitori deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore për gjetjen rastësore.

Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga IKTK-ja ose subjekti i licencuar apo monitoruesi, urdhëron pezullimin e punimeve që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga KTKM-ja.

### **3. TE PERGJITHSHME MBI PERSHKRIMIN E PROJEKTIT**

Qellimi i PPV parashikon ndryshime te treguesve zhvillimore te zones .

Me Vendimin Nr.1 datë 27.07.2022 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

- a. Në kategorinë e përdorimit të tokës,
- b. Në lartësinë e kateve,
- c. Intensiteti etj.

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, vjen si pasojë e nevojës së bashkisë për:

- a. Rritja e nivelit të përdorimit të shërbimeve,
- b. Stimulimi i iniciatave te sektorit te ndërtimit,
- c. Permbushja e nevojave per strehim nisur nga dinamikat e levizjes per banim te popullësisë nga zonat rurale në zonat urbane etj.
- d. Ka pasur kërkesa nga qytetarët të hiqet kushti për ndërtimin e një parku urban për disa njësi.
- e. Ka pasur kërkesa nga qytetarët apo investitorët potencial të cilat kanë kërkuar rishikimin e katgorive të përdorimit të tokës së ppv-së dhe treguesve të zhvillimit për njësi strukturore të caktuara.

Përdorimi i tokës ndahet në këto kategori:

1. Banim,
2. Arsim,
3. Industri Ekonomi,



**Sipas gjendjes aktuale:** Njësia strukturore KZ\_UB\_AR3\_14/315 Kamez shtrihet përgjatë rrugës "Venecia". Kategoritë e lejuara sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë 100% Aktivitete Shoqërore & Argëtim (SHA). Intensiteti (I) I ndërtimit I parashikuar për këtë njësi strukturore është 0 dhe koeficienti I shfrytëzimit të tokës(ksht) është 0. Lartësia në kate është 0. Mënyra e ndërhyrjes në këtë njësi strukturore është rigjenerim.

**Propozimet për ndryshim në pasaportën e njësisë strukturore:**

Bashkia Kamëz ka realizuar korrespondencat me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në lidhje me transferimin e fushës së sportit nga qendër Kamza që ndodhet në njësinë strukturore KZ\_UB\_AR3\_14\_315,(trualli ku sot ndodhet Fusha e Sportit figuron në pronësi të Bashkisë Kamëz) në njësinë strukturore me kod KZ\_UB\_AR1\_1-9 referuar Planit të Detyruar Vendor Valias me Vendim Nr.449 datë 17.09.2020 ku kategoria e përdorimit të tokës është "Hapsirë Publike" ku kjo sipërfaqe figuron në pronësi të Bashkisë Kamëz. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka realizuar dhe marrveshjen me Federatën Shqiptare të Futbollit për ndërtimin e Fushave të Sportit në këtë njësi strukturore me kod KZ\_UB\_AR1\_1-9.Gjithashtu referuar VKM me Nr.396 datë 19.06.2024 (për disa ndryshime në vendimin Nr.468 datë 10.06.2020 për shpalljen e zones së re për zhvillim në fshatin Valias,Bashkia Kamëz) është vendosur zëvendësimi i hartës dhe koordinatave në mënyrë që Bashkia Kamëz të vazhdojë me ndërtimin e projektit të stadiumit dhe fushës ndihmëse.Përsa më sipër përdorimi SHA (aktivitete shoqërore dhe argëtim) në njësinë strukturore KZ\_UB\_AR3\_14/315 mbetet për tu ndryshuar kategoria e përdorimit dhe parametrat e zhvillimit.Duke qenë se do realizohet ndërtimi i godinës së re i Bashkisë Kamëz dhe fakti që kjo njësi strukturore eshte e dokumentuar me certificate të pronësisë në emrin e Bashkisë Kamëz,propozohet që ndërtimi i godinës së re i Bashkisë Kamëz të realizohet në këtë njësi strukturore me kod KZ\_UB\_AR3\_14\_315.Propozohet që kategoria e përdorimit të tokës të bëhet IS(Institucione),Intensiteti I=1 dhe numëri i kateve Nr.kat=3,KSHT propozohet 10%.



*Identifikimi i njësisë strukturore*

Ndryshimet që kërkohen në këtë njësi strukturore bazohen në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	12 of 65
--	----------------------	------------	-------	----------

AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", Udhëzimi Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së për një shtesën në Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Referuar pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM 686/2017, e ndryshuar ndryshimet që kërkohen në njësinë strukturore të sipërpërmendur nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial, në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore si dhe nuk ndryshojmë dokumentin e strategjisë territoriale.

Arsyet për të cilat po aplikojmë me procedurë të thjeshtuar ka si qëllim përshtatjen e kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike në territor, ndryshimet e kategorive/nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën) kategorive të përdorimit të tokës brenda të njëjtit system territorial.

Për të bërë një paraqitje të saktë të gjendjes ekzistuese është bere azhornimi ne terren, shoqëruar me fotografi.



## 2. NJESIA STRUKTURERE KZ\_UB\_IS2\_14/316

Në pasaportën e njësisë strukturore KZ\_UB\_IS2\_14/316 kerkohen keto ndryshime:

- a. Kategoria e përdorimit të tokës, ndryshon nga "IS"-Institucione (100%) të shtohet dhe përdorimi "A2"-Banime & Shërbime.
- b. Intensiteti i ndërtimit, ndryshon nga "2.5" në "4".
- c. Madhësia e parcelës minimale, ndryshon nga "N/A" në "1000 m2"
- d. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, ndryshon nga "50%" në "45%"
- e. Lartësia në kate, ndryshon nga "5" në "9".

**Sipas gjendjes aktuale:** Njësia strukturore KZ\_UB\_IS2\_14/316 Kamëz, në anën veriore të saj shtrihet përgjatë rrugës "Selaniku", në anën jugore të saj shtrihet përgjatë rrugës "Venecia", në anën perëndimore të saj shtrihet përgjatë rrugës Bulevardi "Nënë-Tereza". Kategoritë e lejuara sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë 100% Institucion, Intensiteti (I) I ndërtimit I parashikuar për këtë njësi strukturore është 2.5 dhe koeficienti I shfrytëzimit të tokës(ksht) është 50%.Lartësia në kate është 5.Mënyra e ndërhyrjes në këtë njësi strukturore është rigjenerim .

**Propozimet për ndryshim në pasaportën e njësisë strukturore:**

Përdorimi IS (institucione) në këtë njësi strukturore mbetet për tu ndryshuar kategoria e përdorimit ku përveç përdorimit IS (institucione) të shtohen dhe kategoritë Banim+Shërbim. Bazuar në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor(PPV), e cila përcaktohet madhësinë e parcelës minimumi N/A, Intensiteti I nënjësisë strukturore (I) 2.5 , koefiçienti i shfrytëzimit të tokës (K.SH.T) 50%, është konstatuar që këto faktorë janë bërë shkak për ngadalsimin e zhvillimit në mënyrë progresive të zonës. Rrjedhimisht lind nevoja për përmirësimin e këtyre parashikimeve në bazë të kërkesave të zonës perkatëse. Duke konstatuar që kategoria e përdorimit të tokës shfaq pengesë në zhvillimin urban të zonës, propozohet që krahas përdorimit Institucione të shtohen dhe përdorimet Banim+Shërbim. Gjithashtu Intensiteti i njësive strukturore propozohet të ndryshoj nga 2.5 në 4, madhësia e parcelës propozohet nga N/A në 1000m<sup>2</sup> numri I kateve të ndryshojë nga 5 në 9, gjithashtu KSHT propozohet të bëhet 45 %. Njëpërmjet realizimit të ndryshimit të propozuar në parametrat e zhvillimit të kësaj njësie strukturore synohet që tu jepet e drejta qytetarëve dhe investitorëve zhvillojnë pronën e tyre të cilat kanë potencial për zhvillimin ekonomik të zonës si dhe për t'ju mundësuar banorëve të zonës zhvillimin e pronave të tyre me qëllim ndërtimin e objekteve të banimit për të mundësuar një ndërtesë konform standarteve bashkëkohore.




*Identifikimi i njësisë strukturore*

Ndryshimet që kërkohen në këtë njësi strukturore bazohen në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", Udhëzimi Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së për një shtesën në Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Referuar pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM 686/2017, e ndryshuar ndryshimet që kërkohen në njësinë strukturore të sipërpërmendur nuk bien në kundërshtim me

legjislacionin sectorial, në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore si dhe nuk ndryshojmë dokumentin e strategjisë territoriale.

Arsyet për të cilat po aplikojmë me procedurë të thjeshtuar ka si qëllim përshtatjen e kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike në territor, ndryshimet e kategorive/nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën) kategorive të përdorimit të tokës brenda të njëjtit system territorial.

Për të bërë një paraqitje të saktë të gjendjes ekzistuese eshte bere azhornimi ne terren, shoqëruar me fotografi.





### 3. NJESIA STRUKTURORE KZ\_UB\_AS2\_14/196

Në pasaportën e njësisë strukturore KZ\_UB\_AS2\_14/196 kerkohen keto ndryshime:

- Kategoria e përdorimit të tokës, ndryshon nga "AS"-Institucione (50%) në "A2"- Banime & Shërbime (100%).
- Intensiteti i ndërtimit, ndryshon nga "sipas lejes së zhvillimit/lejes ndërtimit" në "4".
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, ndryshon nga "sipas lejes së zhvillimit/lejes ndërtimit" në "45%"
- Lartësia në kate, ndryshon nga ndryshon nga "sipas lejes së zhvillimit/lejesndërtimit" në "9".

**Sipas gjendjes aktuale:** Njësia strukturore KZ\_UB\_AS2\_14/196.Kamëz, shtrihet përgjatë rrugës "Nazmi Kryeziu" .Kategoritë e lejuara sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë 50% Arsim. Përsa i përket koeficientit i shfrytëzimit të tokës(ksht),lartësia në kate dhe Intensitetit janë përcaktuara sipas lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit. Mënyra e ndërhyrjes në këtë njësi strukturore është rigjenerim.

**Propozimet për ndryshim në pasaportën e njësisë strukturore:**

Përdorimi AS (arsim), në këtë njësi strukturore mbetet për tu ndryshuar kategoria e përdorimit ku nga AS (arsim) në kategorinë Banim+Shërbim.Bazuar në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor(PPV), përsa i përket koeficientit të shfrytëzimit të tokës(ksht),lartësia në kate dhe Intensitetit janë të përcaktuara sipas lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit ku këto parametra të zhvillimit janë bërë shkak për ngadalsimin e zhvillimit në mënyrë progresive të zonës.

Rrjedhimisht lind nevoja për përmirësimin e këtyre parashikimeve në bazë të kërkesave të zones perkatëse. Duke konstatuar që kategoria e përdorimit të tokës shfaq pengesë në zhvillimin urban të zonës, propozohet që kategoria e përdorimit të tokës të ndryshojë nga Arsim(AS) në Banime+Shërbime. Gjithashtu Intensiteti i njësive strukturore propozohet të bëhet 4 dhe numri I kateve propozohet të bëhet 9, gjithashtu KSHT porpozohet të bëhet 45 %. Nëpërmjet realizimit të ndryshimit të propozuar në parametrat e zhvillimit të kësaj njësie strukturore synohet që kjo njësi strukturore të bëhet një zone urbane e zhvilluar duke plotësuar nevojat e qytetarëve për banim.



Identifikimi i njësisë strukturore



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	17 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

Ndryshimet që kërkohen në këtë njësi strukturore bazohen në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", Udhëzimi Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së për një shtesën në Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Referuar pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM 686/2017, e ndryshuar ndryshimet që kërkohen në njësinë strukturore të sipërpërmendur nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial, në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore si dhe nuk ndryshojmë dokumentin e strategjisë territoriale.

Arsyet për të cilat po aplikojmë me procedurë të thjeshtuar ka si qëllim përshtatjen e kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike në territor, ndryshimet e kategorive/nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën) kategorive të përdorimit të tokës brenda të njëjtit sistem territorial.

Për të bërë një paraqitje të saktë të gjendjes ekzistuese është bere azhurnimi ne terren, shoqëruar me fotografi.



#### 4. NJESIA STRUKTURERE KZ\_UB\_A2\_14/427


Në pasaportën e njësisë strukturore KZ\_UB\_A2\_14/427 kerkohen keto ndryshime:

- Intensiteti i ndërtimit, ndryshon nga "2.5" në "4" .
- Madhësia e parcelës minimale,ndryshon nga "500" në "1000"
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës ,ndryshon nga "50%" në "45%"
- Lartësia në kate ,ndryshon nga ndryshon nga "5" në "9".

**Sipas gjendjes aktuale:** Njësia strukturore KZ\_UB\_A2\_14/427. Kamëz, shtrihet përgjatë rrugës "Liria" dhe rrugës "Azem Galica" .Kategoritë e lejuara sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë 100% A (Banim). Intensiteti (I) I ndërtimit I parashikuar për këtë njësi strukturore është 2.5 dhe koeficienti I shfrytëzimit të tokës(ksht) është 50%. Lartësia në kate është 5. Mënyra e ndërhyrjes në këtë njësi strukturore është rizhvillim, tipologjia e ndërtimit është struktura kolektive (Pallat) të Grupuara.

#### **Propozimet për ndryshim në pasaportën e njësisë strukturore:**

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) ku madhësia e parcelës minimumi është 500m<sup>2</sup>, Intensiteti i njësisë strukturore I=2.5, kategoria bazë e përdorimit të tokës është Banim, nënkategoria është Banim+Shërbime, koeficienti i shfrytëzimit të tokës (K.SH.T) është 50%, është konstatuar qe këto faktorë janë bërë shkak për ngadalësimin e zhvillimit në mënyrë progresive të zonës. Pritet të kemi një transformim të lartë zhvillimit të zonës. Rrjedhimisht lind nevoja për përmirësimin këtyre parashikimeve në bazë të kërkesave të njësisë strukturore. Duke konstatuar që këto parametra janë pengesë në zhvillimin urban të zonës, propozohet që madhësia e parcelës minimale të bëhet 1000m<sup>2</sup>, lartësia në kate propozohet 9, Koeficienti I shfrytëzimit të tokës propozohet 45%, Intensiteti i njësisë strukturore propozohet I=4. Duke qenë se kjo njësi strukturore është e pazhvilluar nga ndërtimet e reja ku intensiteti është kryesisht i ulët duke sjellë në këtë zonë vështirësi në plotësimin e nevojave të qytetarëve për banim, ndryshimi i parametrave të zhvillimit do u mundësojë banorëve të zonës zhvillimin e pronave të tyre me qëllim ndërtimin e objekteve të banimit për të mundësuar një ndërtesë konform standarteve bashkëkohore.



Identifikimi i njësisë strukturore

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	19 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

Ndryshimet që kërkohen në këtë njësi strukturore bazohen në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", Udhëzimi Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së për një shtesën në Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 si dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Referuar pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM 686/2017, e ndryshuar ndryshimet që kërkohen në njësinë strukturore të sipërpërmendur nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial, në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore si dhe nuk ndryshojmë dokumentin e strategjisë territoriale. Arsyet për të cilat po aplikojmë me procedurë të thjeshtuar ka si qëllim përshtatjen e kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike në territor, ndryshimet e kategorive/nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës, raportit në % mes (nën) kategorive të përdorimit të tokës brenda të njëjtit sistem territorial.

Për të bërë një paraqitje të saktë të gjendjes ekzistuese është bërë azhurnimi në terren, shoqëruar me fotografi.





	Emertimi Dokumentit:	<b>RAPORT VNM</b>	Page:	21 of 65
--	----------------------	-------------------	-------	----------

Ndryshimet ne keto kater njesi strukurore kane keto objektiva:

- Synojmë të kemi qytete dhe vendbanime ku të gjithë njerëzit të jenë në gjendje të gëzojnë hapësira komode.
- Të përmbushin funksionin e tyre social, duke përfshirë edhe funksionin social dhe ekologjik të tokës, me synimin që progresivisht të arrihet realizimi i plotë i të drejtës për strehim të përputhshëm, si pjesë e përmbajtjes së të drejtës për një standard të përshtatshëm jetese, pa diskriminim. Kjo do të stabilizojë mos largimin e popullsisë dhe rritjen ekonomike të qytetit.
- Mbështetja e Nevojave Tregtare dhe Ekonomike: Zhvillimi i zonave urbane dhe zonave me premise për zhvillim do të ndihmojë në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe tregtisë në qytet, duke krijuar mundësi të reja biznesi dhe vende pune.
- Përmirësimi i Cilësisë së Jetës: Ndërtimi i hapësirave të reja banimi dhe përmirësimi i infrastrukturës urbane do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së jetës për banorët, duke ofruar ambiente të përshtatshme për banim dhe shërbime të mirëqenies.
- Rregullimi i Rrjedhës së Popullsisë: Duke krijuar më shumë mundësi për strehim të përballueshëm dhe zhvillim ekonomik, vendbanimet urbane dhe zonat me premise për zhvillim mund të ndalojnë migrimin nga fshatrat në qytete, duke rregulluar rrjedhën e popullsisë dhe duke parandaluar urbanizimin e paplanifikuar.
- Përfitimet Ambientale: Planifikimi i hapësirave urbane në përputhje me standartet mjedisore dhe ekologjike mund të sjellë përfitime për ambientin, duke përfshirë ruajtjen e zonave të hapura, promovimin e transportit publik dhe zonave të gjelbëruara.
- Ndikimi Pozitiv në Komunitetin Lokal: Zhvillimi i zonave urbane dhe përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe komunale do të ndikojë në rritjen e ndjenjës së përfshirjes dhe solidaritetit në komunitetin lokal, duke krijuar një mjedis më të mirë për të gjithë banorët.

#### **4. PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONEN E PROJEKTIT**

##### **4.1 PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES**

Në lidhje të ngushtë me elementet klimatike dhe ato te tokes, bimësia paraqet një model të dukshem vertikale të shpërndarjes se saj.

Në zonën e ahut, ku mbizoterojne haloret, ndikimi i pyllit është ndjerë gjatë gjithë vitit. Në periudhën midis Prillit dhe Tetorit, të pasura me reshje, nuk jane vetëm kurotat e pemëve që mbajnë ujë, por edhe gjethet te rena mbajë një sasi te madhe te rreshjeve. Kështu, koeficientet e rrjedhjes maksimale janë më të ulëta për territorin brenda pyll.

Në pranverë, që bora shkrihet ngadalshëm në zonën e pyjeve, rrjedhja maksimale është më e ulët se sa në ato të tjera. Duhet vënë në dukje se pyjet pengojnë erozionin dhe derdhet e shpejta te rrëkeve në terrenet shumë të pjerrat. Në zonën malore (1000-1700 rn mbi msl), ku ndodhet zona fitoklimatic (gjethet e pyjeve janë përhapur), ndikimi i pyllit është më i rëndësishme gjatë periudhës së vegjetacionit, sepse e mbane të bllokuar një sasi e konsiderueshme rreshjesh në tokë . Pyjet gështenjë (800-1200m), kanë të njëjtin efekt.

Në përgjithësi, në zonat me shkallë të lartë pyllëzime, pasojat e tjera të ndikimit te pyjeve në rrjedhën e regjimit te lumit janë vretur, të tilla si: rritja e të ushqyerit te burimeve nëntokësore, ruajtjen lagështi apo uljen e avullimit nga sipërfaqja e tokës (për shkak të fenomenit hije). Shkuret e përhapura fitoklimatic në lartësin 500 m mbi nivelin e detit. Kjo zonë luan një rol të rëndësishëm në uljen e plotes torrenciale në rrjetin hidrografik.


Në rastet kur shkurret mungojne në zonë, pasojë do të jetë një rrjedhë torrenciale dhe erozion te shpateve, kështu që fornimi i rrjedhjes baze është zbutur. Pyjet ushtrojn e keshtu efektet e përmendura më sipër te tyre pozitive dhe negative në zonat e uleta.

Ndikimi i bujqësisë në rrjedhën e lumit në këtë zonë varet nga zhvillimi i metodave të kultivimit të tokës. Tokat e kuitvuara ndikojne në rrjedhën e lumit duke mbledhur dhe ruajtur ujin e rreshjeve, veçanërisht gjatë periudhave të thata. Pyjet perbejne rreth 37% të sipërfaqes ujëmbledhës te Erzenit.

#### 4.1.1 ZONAT E MBROJTURA DHE MONUMENTET NATYRORE QARKU TIRANE

Edhe pse një vend i vogël, Shqipëria dallohet për larminë e madhe të biodiversitetit dhe peizazheve. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve krijojnë kushte të favorshme për mbajtjen dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh të florës dhe faunës, përfshirë një sërë llojesh endemike dhe sub-endemike. Rreth 16% e territorit të Shqipërisë është përfshirë në zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme (Figura 1). Këto zona përmbledhin vlerat natyrore më të rëndësishme të vendit si nga pikëpamja ekologjike ashtu edhe për nga rëndësia ekonomike. Sipas kategorizimit të IUCN (Unionit Nderkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës), kategoritë e zonave të mbrojtura janë:

#### RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA




Rrjeti i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri (Burimi: AKZM)

1. Rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (Kategoria I);
2. Park kombetar (Kategoria II);
3. Monument natyror (Kategoria III);
4. Rezervat natyror i menaxhuar\ zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
5. Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
6. Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara\ zonë e mbrojtur me perdorim të shumefishte (Kategoria VI).




Fig: Zonat e Mbrojtura Qarku Tirane. Burimi Gjeoportali AKZM









## KONKLUZION

- Zona në studim nuk ben pjese në zonat e mbrojtura me interes të vecante qe mbrohen nga konventat nderkombetare, si; Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore (konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës), etj.**
- Zona ne studim nuk ka te identifikuar asnje Monument Natyror**

### 4.1.2 LLOJET ENDEMIKE TE TIRANES

Vrojtimet dhe humultimet e bëra për habitatet natyrore të rrethit të Tiranës kanë evidentuar praninë e një numri të madh të llojeve dhe formacioneve bimore. Hapësira e zonës përfshin zonat kodrinore, paramalore, malore dhe kullotat alpine (zonës së Dajtit – Malit me Gropa - kodrat e Tiranës) të cilat kanë mbi 860 lloje bimësh të larta, të shpërndara në rreth 90 familje. Format jetësore mbizotërohen nga hemikriptofitet (37 %), terofitet (28 %) dhe gjeofitet (17 %), e cila është dëshmi e hapësirave të hapura (çeltirave) dhe dendësinë relativisht të ulët të kurorës së bimëve drunore, shkallës së madhe të rrëgjimit të kateve shkurre dhe drunore. Edhe sasia e pakët e fanerofiteve (13 %) është tregues jo vetëm i përfaqësimit jo të lartë të llojeve drusore, por edhe i shfrytëzimit të madh të tyre për qëllime ekonomike, e cila ka sjellë edhe proceset degraduese të bimësisë në zonë. (Dring et al., 2002; Dumishllari, 2006; Dumishllari & Buzo, 2008; Kalajnxhiu, 2006; Kalajnxhiu et al., 2004; Krutaj et al., 2006; Shuka et al., 2007, etj.). Duke u mbështetur në klasifikimin vertikal në zonën e Tiranës gjenden katër zona fitoklimatike:

- ✓ Zona e shkurretave mesdhetare, e cila shtrihet në lartësinë nga 300-600 metër mbi nivelin e detit. Fizionomia floristike e saj përfaqësohet nga shkurreta me gjethë gjithnjë të blerta dhe nga shkurretat që i lëshojnë gjethet në dimër. Si shkurre mesdhetare me gjethë gjithnjë të blerta dhe të lëkurta vlejnë për t'u përmendur llojet: ilqja (*Quercus ilex*), xina (*Pistacia lentiscus*), mare (*Arbutus unedo*), shqopa (*Erica arborea*), mersina (*Myrtus communis*), gjineshtra (*Spartium junceum*), morenxa (*Smilax aspera*) si dhe bimë që i lëshojnë gjethet gjatë dimrit si driza

Emertimi Dokumentit:	<b>RAPORT VNM</b>	Page:	26 of 65
----------------------	-------------------	-------	----------

(*Paliurus aculeatus*), frashëri (*Fraxinus ornus*), shkoza (*Carpinus orientalis*) etj. Flora e bimësisë barishtore e formacionit të makjes në përgjithësi është e varfër dhe monotone për shkak të mbulesës së dendur të saj. Ajo është e pasur edhe me bimë të ulëta kriptogame, si Likenet (Lichenes) – mbi trungjet dhe gurët, Briofitet (Bryophyta), në tokë, drurë ose gur, Fierera , (Pteridophyta), Kërpudha (Mycophyta) .

- ✓ Zona e dushkajave e cila shtrihet në lartësitë 500 -1000 m, me përzjerje drurëshsi shparth (*Quercus frainetto*), qarr (*Q. cerris*), bungë (*Q. petraea*), bungëbutë (*Q. pubescens*), frashër (*Fraxinus excelsior*), shkozë (*Carpinus orientalis*), mëllezë (*Ostrya carpinifolia*), gështenjë (*Casatanea sativa*), lajthi (*Coryllus avellana*), thanë (*Cornus mas*), goricë (*Pyrus amygdaliformis*), rrallë ilqe (*Q. ilex*) etj . Ky kat në përgjithësi përfaqësohet nga pyje të rrallë, gjë e cila lejon që të depërtojë drita dhe si pasojë rritet elementi i nënpyllit dhe një bimësi e pasur barishtore si p.sh. manushaqja (*Viola odorata* L.), lule lepuri (*Pulmonaria officinalis* A.kern), milca (*Melissa officinalis* I.) dhe shumë gramore midis të cilave përmendim belizmën (*Andropogon gryllus* L.), telishin (*Dactylis glomerata* L.)
- ✓ Zona e ahut që shtrihet në lartësitë 1000 - 1600 m dhe kryesohet nga ahu (*Fagus sylvatica*). Ahu gjendet në grumbuj të thjeshtë, deri në lartësinë 1570 m, si dhe me përzjerje llojesh : panjë fletëgjërë (*Acer obtusatum*), mëllezë (*Ostrya carpinifolia*), bungë (*Q.petraea*) , frashër (*Fraxinus excelsior*), pishë e zezë (*Pinus nigra*), rrobull (*P.heldreichii*), hartinë *P.sylvestris*), bli (*Tiliaplathyphyllos*) etj. Në disa maja mbi 1000 m, pylli i ahut është i paprekur, i virgjër, pothuajse natyror.
- ✓ Zona e kullotave malore është tepër e kufizuar, në lartësitë mbi 1500 m. Sipas Dumishllari & Buzo (2008), sipërfaqe të medha dhe me vlerë zënë livadhet eumesofile të vendosur në toka relativisht të thella të murrme pyjoreme Poasp. diverse, *Festuca panciciana*, *Cynosurus crastatus*, *Trifolium pratense* , *Phleum alpinum*, *Koeleria splendens*, *Asphodelus albus* , *Narcissus poeticus*. Çeltirat pyjore dhe sipërfaqet e zhveshura gurishtore, në pjesën më të madhe përfaqësohen nga kullota të thata me *Festuca* sp. diverse (*F. bosniaca*) , *Bromus* sp . diverse (p.sh.*B. erectus*), *Teucrium montanum*, *Stipa pennata*, *Thymus cherlerioides*, *Th . striatus* . Zënë vend të rëndësishëm livadhet gjysmë të thata (meso - kserofit), me *Agrostiscapillaris*, fier (*Pteridium aquilinum*), *Thymus striatus* etj. Shpatet e sheshta dhe gropat mbuloohen nga livadhe mesofile të ftohta, me *Poo* sp. diverse dhe *Nardus stricto* (Dumishllari, 2006 ; Dumishilar.Buzo , 2008 .

#### 4.1.3 FLORA

Tirana bën pjesë në brezin e shkurreve dhe drurë mesdhetarë ku përmendim pyjet halore, gjethegjërë. Në zonat përreth Tiranës vazhdojnë të mbijetojnë në pakicë si: makiet, shiblaku ,driza (*paliurus spinachristi*), cermedelli (*cotunus coggygria*), shqemia (*rhus coriaria*), shëgë (*punica granatun*), gorrica (*pyrus amygdaliformis*), murrizët, thana, etj. Në këtë zonë janë mbjellë bimë zbukuruese (*Pinus nigra*, *picea conica*, *talus baccata*, *juniperus virginiana*, etj). Ndërsa në mjedisin përreth sheshit në studim përreth sidomos në parcela të pë shfrytëzuara dalloheshin barëra dhe fieri shqipja (*pteridium aquilinum*), etj. Në sheshin që do të shfrytëzohet vihet re se është e zhveshur nga bimësia e lartë dhe mbizotërojnë shkurret e mbjella nga vete banoret mqs aktualisht sherben kryesisht si zone banimi e ndertuar gjate periudhes se informalizimit.Një vend të rëndësishëm në tipin e vegjetacionit që ndeshet këtu zënë pyjet higrofile, të cilët i përkasin klasave Alno-Populeta dhe Salicetea purpurea. në këto lloj pyjesh në përgjithësi nuk formohet humus dhe toka është lymore, kështu që kushtet edafike janë krejtësisht të ndryshme nga ato të formacioneve të tjera bimore.Substrati në të shumtën e rasteve ka karakter zallishte dhe në këto mjedise rriten shoqërime me *Platanus orientalis* i shoqëruar me shkure higrofile si *Salix elaeagnos*, *Tamarix parviflora* etj., ndërkohë që disa ujëra me rjedhje të qetë substrakti është lymor e këtu rriten shoqërime me *Almus glutinosa*, *Salix alba*, *Alnus incana* etj.

#### 4.1.4 FAUNA

Habitatet natyrore që gjenden në brendësi të territorit të Qarkut Tiranë karakterizohen nga një diversitet i lartë dhe gjendje e ruajtur. Siperfaqja e madhe e zonave të mbrojtura (P.K Mali i Dajtit, Peisazhi i mbrojtur Mali me Gropa - Bizë - Martanesh), kurora e gjelbër e Tiranës, mjediset ujore të përfaqësuar nga lumenj, liqene dhe rezervuarë, krijojnë kushte të përshtatshme për jetesën e një numri të lartë gjallesash. Nga inventarizimet e kryera të grupeve të synuara të faunes (gjitarë, shpendë, zvarranikë , amfibe) rezulton se gjenden shumë lloje të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një numëri madh i vertebrorëve që gjenden në zone gëzojnë mbrojtje strikte (SPS- specie në mbrojtje strikte) ose janë të mbrojtura (95- specie të mbrojtura) nga ligji shqiptar ligji për Mbrojtjen e Faunës dhe aktet rregullatore përkatës).

Tabela : Numri i llojeve të evidentuara në brendësi të territorit të Tiranës

Taksoni	Nr.llojeve qe gjenden ne zonen e Tiranës	Nr.llojeve ne listen kombetare	Perqindja %
Gjitare	53	71	74.6
Shpende	130	330	39.3
Zvarranike	28	37	75.6
Amfibe	13	15	86

Për zonën në studim nuk dallohet për ndonjë botë të pasur shtazore, ku karakteristika e zonave përreth zonës së Tiranës janë kumriet. Për zonën në studim nuk zoterohet ndonjë material i hollësishëm. Prania e kafsheve të egra në këtë zonë mungon. Zogjtë që karakterizojnë zonën janë si: pellumbi (*Streptopelia decaoto*), trumcaku (*Troglodytes*), harabela (*passer domesticus*), kumriet, etj. Ndërsa insekte kemi brumbuj, grerëza, milingona, pilivesa, mushkonja, flutura etj. Nuk vihen re prania e ndonjë specie që është e përfshirë në "Librin e Kuqë". Në sistemin e rjedhjeve ujore, përrenjve të zonave perreth, takohen lloje kozmopolite të molusqeve si *Theodoxus*, *Bithynia*, *Holandriana*, *Lymnaea stagnalis* etj. Nga përfaqësuesit e amfibëve ndeshen llojet *Bufo viridis*, *Bufo buffo*, *Rana sp.* etj. ndërkohë që në rjedhjet e mësipërme ndeshet *Triturus vulgaris*. Llojet kryesore të peshqëve të evidentuar këtu janë: *Alburnoides bipunctatus*, *Barbatula sp*, *Cobitis taenia* dhe *Barbus sp.*, *Leuciscus cephalus* etj. Gjitaret në zonë janë të pranishëm përmes dhelprës (*Vulpes vulpes*), ujkut (*Canis lupus*), Lepurit të egër (*O. corniculat*) etj.

#### KONKLUZION:


- Projekti i propozuar nuk cenon Floren dhe Faunen e Zones duke u gjendur ne distanca te konsiderueshme nga to
- Rekomandohet qe gjate zhvillimit te projektit te merren masa nepermjet shtimit te siperfaqeve te gjelberta me bimesine e zones



Fig: Përhapja e Faunës së Egër në Shqipëri (Burimi AKM)

#### 4.2 MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK

Qarku i Tiranës është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 1.586 km<sup>2</sup>. Qarku i Tiranës i përfshin pese bashki (Tiranë, Kamza, Vora, Rogozhina dhe Kavaja). Qendra e Qarkut të Tiranës ndodhet në qytetin e Tiranës. Qarku i Tiranës kufizohet në veri me Qarkun e Durrësit, në verilindje me Qarkun e Dibrës, në juglindje me Qarkun e Elbasanit, në jug me Qarkun e Fierit dhe në perëndim me Detin Adriatik. Rajoni i Tiranës ka një popullsi prej 800.197[1] banorësh (2009). Kryeqendra e Qarkut është qyteti i Tiranës. Sipas Censurit të vitit 2020 qarku ka një popullsi prej 906,166 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil ajo numëron akoma me shume.



Qarku shtrihet në një sipërfaqe prej 1652 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 550 banorë/km<sup>2</sup>. Burimet kryesore të ekonomisë urbane janë turizmi, industria, rrjeti i bizneseve dhe manifaktura me material porositës, e cila shërben përgjithësisht për tregun e huaj. Zona rurale që i bashkëngjitet qytetit është e njohur për blegtorinë e imtë dhe për produktet blegtorale shumë cilësore.

#### 4.3 TRASHEGIMIA HISTORIKE DHE KULTURORE

Trashegimia Kulturore e Qarkut Tirane është e larmishme, me poshte po rendisim disa prej tyre:

- ✓ Keshtjella e Petreles ndodhet 18 km larg qytetit të Tiranës. Kalaja ngrihet mbi një koder shkembore dhe ka një trajtë trekëndore me dy kulla vrojtuese.
- ✓ Kalaja e Doresit ndodhet mbi një koder tepjerret në komunën Peze. Pjesa më e madhe është e rrethuar me mur, kurse pjesa e mbetur është e mbrojtur nga shkëmbi natyral.
- ✓ Kalaja e Prezes është një keshtjelle e vogël e rindërtuar në shekullin e XIV mbi themelet e kalasë antike qyteza e Parthineve.
- ✓ Kalaja e Dajtit ndodhet me një lartësi prej 1200 m mbi nivelin e detit.
- ✓ Kalaja e Viles këtu ruhen edhe gjurmët e një fortifikimi të vonë antik.
- ✓ Keshtjella e Tujanit ndodhet mbi një koder me shpatë të pjerrëta, një nga korridoret nepermjet të cilit kalonte rruga për në Diber.
- ✓ Xhamia e Tiranës paraqet një rast tipik të traditës shqiptare në arkitekturën e Xhamive. Është shpallur monument kulturor.
- ✓ Kulla e Sahatit në vitin 1928 u rikonstruktua në pjesën e sipërme të saj duke u lartësuar në 35 m. Është shpallur monument kulturor.
- ✓ Tyrbja e Kapllan Pashes ndodhet aty ku takohen rruga e Sahatit me atë të Elbasanit.
- ✓ Tyrbja e Nuses gjendet në fshatin Mullet pranë kishës së Maxhares dhe daton në shekullin XIV.

- ✓ Kisha paleokristiane e Tiranës është ndër monumentet më të vjetër në Tiranë. Siti arkeologjik emërtohet edhe me emrin "Mozaiku i Tiranës.
- ✓ Kisha e Maxharrës në Mullet është e rrenuar.
- ✓ Ura e Tabakeve është ndërtuar prej guri mbi lumin e Lanës në gjysmën e parë të shek XVIII Nga esnafi i Tabakeve. Është shpallur monument kulture.
- ✓ Kalaja e Tiranës përbën qendrën e një vendbanimi të emërtuar me një variacion emrash që në shekujt e parë të erës sonë.

#### Monumentet e Natyrës në Parkun e Tiranës:


- ✓ Shpella e Zezë ose e Pellumbasit 25 km në juglindje të Tiranës në Parkun Kombëtar të Dajtit. Aty janë bërë zbulime interesante si skeletet e arinjtë të shpellave që kanë jetuar nga 10000 deri në 400000 vjet më parë. Ajo është një shpellë karstike e mbushur me stalaktite dhe stalagmite dhe përbën një objekt me vlerë si dhe për qarkullimin e ujerave nëntokësore të saj.
- ✓ Shkalla e Tujanit ndodhet në luginën e lumit të Tiranës. Ka formën e një kanioni . Ka guva e shpellave karstike që e bëjnë edhe një ekosistem karstik. Ky monument është i pershtatshëm për itineraret ditore turistike që përfshijnë rrethinat e Tiranës.

#### Biomonumente:

- ✓ Rrapi i Ndroqit ndodhet në qendër të fshatit. Vjen emri i tillë pasi vite më parë organizohej dita e pazarit. Rreth 400 vjeçar, lartësia e tij 15-17m, diametri i trungut 2.2m.

## 4.4 KLIMA

Duke iu referuar ndarjes klimatike të Shqipërisë kjo zonë bën pjesë në nënzonën mesdhetare fushore qendrore dhe në nënzonën mesdhetare kodrinore qendrore (Vako, 2014). Sipas përcaktimit që bëhet në Hartën e Zonave Klimatike të Shqipërisë të përpiluar nga Instituti Hidrometeorologjik, i gjithë territori i bashkisë së Kamzës ka një klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Karakteristikë për stinën e dimrit janë shirat, të cilët në mjaft raste janë të dendura. Në shumicën e vendit një pjesë e reshjeve ndodh edhe gjatë vjeshtës së vonë dhe në prag të pranverës. Një tipar i dallueshëm i klimës së këtij territori është se aty përfshihen pothuajse të gjitha llojet e klimave të Shqipërisë, nga ajo mesdhetare fushore, deri tek ajo mesdhetare malore. Temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 5,8°C në 15,1°C. Temperaturat maksimale absolute kanë arritur në 41,5 ndërsa ato minimale absolute në -10,5°C.



Harta e zonave klimatike

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	31 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

#### 4.4.1 RREZATIMI DIELLOR

Shqipëria, me një pozicion të favorshëm gjeografik në pellgun e detit Mesdhe, ka kushte klimatike shumë të favorshme për shfrytëzimin e energjisë diellore. Intensiteti i lartë i rrezatimit diellor, kohëzgjatja e këtij rrezatimi, temperatura dhe lagështia e ajrit etj. klima mesdhetare, me një dimër të butë dhe të lagët dhe verë të nxehtë dhe të thatë përcaktojnë një potencial energjetik me të madh se potenciali energjetik mesatar për shfrytëzimin e energjisë diellore.

Vendi ynë konsiderohet me regjim të mirë të energjisë diellore dhe potencial të lartë të rrezatimit diellor. Energjia diellore është një burim energjie mjaft premtues për të ardhmen dhe përdorimi i saj është potencial, pasi është një burim natyror energjie i pashtershëm, është rezerva natyrore me të madhe e energjisë që është e shpërndarë kudo në botë në sasi me të mëdha se sa nevojat tona për energji, është e pastër dhe shfrytëzimi i saj nuk kërkon shpenzime të tjera, nuk paraqet asnjë rrezik për ndotjen e mjedisit.

Territori i Shqipërisë shtrihet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit në bregun lindor të detit Adriatik dhe Jon. Ajo është e vendosur në mes gjerësive  $39^{\circ} 38'$  -  $42^{\circ} 38'$  dhe gjatësive  $19^{\circ} 16'$  -  $21^{\circ} 04'$ . Falë kësaj pozite gjeografike, Shqipëria i përket rripit të klimës mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë, me ditë të gjata me diell dhe dimër të butë me rreshje të bollshme. Nisur nga sa thamë më sipër, territori i Republikës së Shqipërisë është ndarë në 4 zona kryesore klimatike, ku luhatjet e elementeve klimatike brenda tyre janë në kufij relativisht të vegjël. (Harta1) Këto zona emërtohen si më poshtë:

- f* Zona Mesdhetare Fushore;
- f* Zona Mesdhetare Kodrinore;
- f* Zona mesdhetare Paramalore;
- f* Zona Mesdhetare Malore.

Instituti Hidrometeorologjik ka nxjerrë rezultate në bazë të trajtimit klimatologjik-statistikor të informacionit aktinometrik dhe heliografik për vlerësimin e shpërndarjes territoriale të rrezatimit diellor. Këto vlerësime janë mbështetur sipas kushteve tona klimatike dhe duke marrë parasysh gjithashtu serinë kohore prej 15 vjetësh të vëzhgimit të drejtperdrejtë në 26 stacione aktinometrike dhe serinë kohore prej 30 vjetësh vëzhgim për kohëzgjatjen e rrezeve të diellit.

Në territorin e vendit tonë kemi një potencial energjetik diellor të konsiderueshëm, ku shumë zona të saj i ekspozohen një rrezatimi që shkon nga  $1185 \text{ kWh/m}^2$  në vit deri me  $1700 \text{ kWh/m}^2$  në vit. Vlen të përmendet që pjesa perëndimore e Shqipërisë, veçanërisht jug perëndimi i saj ka një energji diellore të konsiderueshme. Që shkon deri me  $2200 \text{ kWh}$  në vit.

Në figurën 1 izolinta  $1500 \text{ kWh/m}^2$  në vit e ndan në dy pjesë pothuajse të barabarta territorin e Shqipërisë. Çdo  $\text{m}^2$  e sipërfaqes horizontale në këto pjesë të territorit ka mundësi praktike të marrë deri në  $2200 \text{ kWh/m}^2$  në vit (në këto rast flitet për kushte të një moti anticiklonar). Ndersa në kushte të çfaredoshme moti e njëjta sipërfaqe merr mesatarisht rreth  $1700 \text{ kWh}$  në vit.




Fig 1: Shperndarja territoriale e sasise vjetore te oreve me djell

Fig 2: Rezatimi mesatar ditor (kWh/m2 ne vit)

Tabele: Rrezatimi diellor vjetor (kWh/m2 ne dite)

Qytetet	Shkoder	Peshkopi	Tirane	Vlore	Erseke	Sarande
Janar	1.70	1.55	1.80	2.15	1.90	1.90
Shkurt	2.30	2.30	2.50	2.85	2.70	2.40
Mars	3.35	3.25	3.40	3.90	3.40	3.60
Prill	4.50	4.15	4.20	5.00	4.40	4.80
Maj	5.45	5.25	5.55	6.05	5.60	5.80
Qershor	6.10	5.85	6.40	6.80	6.40	6.80
Korrik	6.50	6.25	6.70	7.20	6.80	6.10
Gusht	5.55	5.45	6.05	6.40	5.90	4.80
Shtator	4.45	4.35	4.70	5.15	4.70	3.60
Tetor	2.90	2.90	3.20	3.50	3.10	3.20
Nentor	2.10	1.85	2.15	2.40	2.10	2.10
Dhjetor	1.70	1.50	1.75	1.85	1.80	1.80

#### 4.4.2 TEMPERATURAT

Tirana ben pjese ne hemisferen veriore. Vera ne kete qark fillon ne Qershor dhe perfundon ne Shtator. Muaji me lageshtine relative me te larte eshte Dhjetori (73.33%) dhe muaji me lageshtine minimale



eshte Gushti (62.69%). Muaji me numrin e diteve me me shume shi eshte Dhjetori (12.77 dite) dhe muaji me numrin e diteve me me pak shi eshte Korriku (5.1 dite). Klima ne Qarkun e Tiranës eshte e ngrohte ku dimri karakterizohet me me shume rreshje. Temperatura mesatare vjetore eshte 14.8°C dhe niveli mesatar i rrreshjeve eshte 1136mm.

Tabela: Te dhena mbi temperaturat e ajrit ne Qarkun Tirane

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Temp Mes °C	5.2 °C	6.5 °C	9.6 °C	13.3 °C	17.5 °C	21.8 °C	24.4 °C	24.7 °C	20.2 °C	15.9 °C	11.5 °C	6.7 °C
Temp Min °C	1.5°C	2.2°C	4.5°C	7.9°C	12°C	16.1°C	18.6°C	18.9°C	15.4°C	11.4°C	7.5°C	3.2°C
Temp Max °C	9.8°C	11.2°C	14.6°C	18.2°C	22.2°C	26.5°C	29.3°C	29.9°C	25.1°C	20.8°C	16.1°C	11.1°C
Rreshjet mm	104	107	112	108	86	49	33	33	96	118	150	140
Lageshtia %	73%	70%	71%	71%	73%	69%	64%	63%	69%	73%	73%	73%
Dite me shi	7	8	8	10	8	5	4	4	7	7	8	10
Oret mes me diell	6.6	7.3	8.5	9.9	11.4	12.5	12.7	11.9	10.2	8.5	7.3	6.4

Figura 12 paraqet temperaturat mesatare vjetore si dhe temperaturat minimale mesatare dhe maksimale mesatare për zonën në studim. Me një mesatare prej 23.3°C, Korriku është muaji më i nxehtë. Temperaturat më të ulëta të vitit regjistrohen në Janar kur është vetëm 1.5°C.




Figure 12. Shperndarja vjetore e temperaturës se ajrit (vendmatje Tirane)

Temperatura mesatare ne Kamez ka një ecure normale me një maksimum në muajt e verës dhe minimum në muajt e dimrit. Kështu muaji më i ftohte i vitit është Janari ku temperaturat mesatare është 4. Ndersa muaji më i ngrohtë është muaji korrik dhe gusht me vlerë të temperaturës mesatare 24.2°C.

#### 4.4.3 Reshjet

Në diagramë janë dhënë treguesit e reshjeve dhe lidhja e tyre me temperaturën. Si vecori e pergjithshme e reshjeve është se ato janë me tëper në shpatet perendimore e juperendimore të maleve dhe me pak në shpatet lindore. Një shperndarje e tille është e lidhur me vendosjen e relievit dhe trajktoreve të levizjes se ciklonëve. Zakonisht dimri e vjeshta janë të lageshta, pranvera e paqendrueshme dhe vera është e thate.





Diagrama Klimaterike (vend-matja Tirane).

Bora. Reshjet në forme bore janë një dukuri relativisht e rrallë për këtë zonë. Numri i diteve me shtrese debore arrin deri në 4.8 dite në vit. Maksimumi i shtreses së bores arrin në muajin janar me trashësi 20 cm.

#### 4.4.4 Era

Në gjysmën e ftohtë të vitit mbizotërojnë erërat e kuadrantit të lindjes, ndërsa gjatë periudhës së ngrohtë ato të kuadrantit perëndimor. Shpejtësia mesatare e erës varion nga 4.4 m/sek (qershor) deri 5.7 m/sek (shkurt), vlera mesatare vjetore arrin 5.1m/sek. Shpejtësia mesatare më e madhe gjatë gjithë vitit vërohet sipas drejtimeve VP (5.9 m/sek) dhe VL (5.5 m/sek). Shpejtësia maksimale e rregjistruar ka arritur vlerën 24 m/sek sipas të dhënave meteorologjike të IGJEUM. (Vako, 2014). Mesatarja e drejtimit të erës në Kamëz varion shumë gjatë vitit. Era është kryesisht nga jugu për 3.6 javë nga 29 Marsi deri 23 Prilli me pikun e saj prej 35% në 6 Prill. Era fryn kryesisht nga lindja për 1.2 muaj, nga 23 Prilli deri në 28 Maj dhe për 7.2 muaj nga 24 Gushti deri në 29 Mars, me pikun e saj prej 33% në 12 Maj. Era fryn kryesisht nga Perëndimi për 2.9 muaj, nga 28 Maj deri në 24 Gusht me pikun e saj prej 35% në 29 Qershor.



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	35 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

#### 4.5 GJEOLGJIA DHE GJEOMORFOLOGJIA

Në territorin e bashkisë së Kamzës, dalin në sipërfaqe shkëmbinj të moshave mesozoike dhe kenozoike. Këta shkëmbinj kanë veçoritë e tyre sipas zonës gjeotektonike së cilës i përkasin. Përshkrimi gjeologjik bazohet në Hartën Gjeologjike shk. 1:100 000, botimi i vitit 2014, si dhe në shumë studime të kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Bazuar në hartë dhe zonën tektonike të bashkisë dallohen dy zona që përfaqësohen nga depozitime të miocenit të sipërm me dhera ranore, argjila, dhe depozitime të Pleistocen-Holocenit që paraqiten në formën e rërave, zhavore, alevrite. Nga pikepamja gjeologjike, territori i Bashkisë Kamzë është ndërtuar mbi formacione të Depresionit Pranë-Adriatik (D.P.A) dhe të Kuaternarit.

Formacionet e Depresionit Pranë-Adriatik (D.P.A) janë depozitime mollasike dhe përgjithësisht shtrihen transgresivisht mbi formacionet e poshtështruara të zonës Jonike dhe zonës së Krujës. Depozitimet mollasike ndërtojnë pjesën perëndimore e qendrore të territorit të qarkut të Tiranës. Depozitimet mollasike të Serravalianit dhe Miocenit të Sipërm të pandarë (N1 3) janë përshkruar më vete. (E. Bedini, N. Vuckzaj, 2014)

##### **Serravaliani (N1<sup>2s</sup>)**

Depozitimet e Serravalianit (N1<sup>2</sup> s) përhapen në pjesën qendrore e veriore të zonës në studim. Depozitimet e Serravalianit të Depresionit Pranë-Adriatik përbehen nga argjila, gëlqerorë litotamnik dhe alevrolite me thjerrza ranore. Trashësia është 2500-3300 m. Depozitimet e Serravalianit takohen edhe në depresionin e Tiranës. Ato shtrihen në pjesën juglindore të sinklinalit të Tiranës. Në krahun perëndimor Serravaliani shtrihet pa tregues të qartë të transgresionit, mbi formacionin shlior të Langianit, ndërsa në krahun lindor ai shtrihet transgresivisht mbi Burdigalianin. Më në veri depozitimet e Serravalianit shtrihen transgresivisht dhe me diskordancë të theksuar këndore mbi formacionet e zonës së Krujës. Depozitimet e Serravalianit përbehen nga alevrolite, argjila, konglomeratë, ranorë, gëlqerorë ranorikë, gëlqerorë litotamnik, etj. Trashësia është rreth 1300 m.

##### **Mioceni i Sipërm (N1<sup>3</sup>)**

Konsiderohet se një ndarje e qartë e Tortonianit dhe Mesinianit në depresionin e Tiranës, nuk është e mundur për shkak të mungesës së faunës së përshtatshme. Kështu megjithëse në sinklinalin e Tiranës ka prerje në disa lokalitete ku depozitimet e Tortonianit mund të dallohen saktë nga ato të Mesinianit. Mioceni i Sipërm në harta të shkallëve të vogla të paraqitet i pandarë. Në depresionin e Tiranës, depozitimet e Miocenit të Sipërm përhapen nga miniera e Krrabës dhe vazhdojnë në veriperëndim nga Mushqetaja deri në Manëz dhe në lindje në Skuterrë-Priskë e Burizanë, duke ndërtuar të dy krahët e depresionit. Në depresionin e Tiranës veçohen katër formacione të depozitimeve të Miocenit të Sipërm: (1) Formacioni Priska. Pjesa e poshtme e prerjes përbëhet nga ranorë shtresë trashëderi masivë. Në pjesën e sipërme shfaqen gëlqerorët litotamnik. Trashësia është 150-400 m. (2) Formacioni Skuterra. Përfaqësohet nga ndërthurje paketash të trasha argjiloro-alevrolitike. Trashësia është 300-380 m. (3) Formacioni Iba. Përfaqësohet nga ranorë shtresë trashë deri masivë. Trashësia është 180-460 m. (4) Formacioni Mëzezi. Përfaqësohet nga ranorë, alevrolite e argjila. Trashësia është 450-670 m. Në pjesën juglindore të depresionit të Tiranës, depozitimet e Miocenit të Sipërm, vendosen transgresivisht mbi depozitimet e Serravalianit e ato më të vjetra. Në krahun lindor të depresionit, megjithëse gjatë gjithë kontaktit me gëlqerorët e strukturës së Dajtit kanë marrëdhënie tektonike, fillimisht ato kanë qenë transgresive. Trashësia e depozitimeve të Miocenit të Sipërm varjon nga 700 m në Zall-Herr, në 1400 m në prerjen e Krrabës.

##### **Tortoniani (N1<sup>3</sup> t)**

Depozitimet e Tortonianit përgjithësisht vijnë normalisht mbi ato të Serravalianit. Në territorin e qarkut të Tiranës, përveç depozitimeve të depresionit të Tiranës të cilat janë përfshirë në Miocenin e Sipërm të pandarë, depozitimet e Tortonianit takohen në Pezë e Madhe, sinklinalin e Vrapit etj. Depozitimet e Tortonianit përgjithësisht mund të ndahen në dy pako: (a) ranorë me ndërshtresa të trasha argjilore dhe alevrolitore. Trashësia 500-700 m. (b) ranorë shtresë trashë. Trashësia 250-500 m.

##### **Mesiniani (N1<sup>3</sup> m)**

Depozitimet e Mesinianit vijnë stratigrafikisht mbi ato të Tortonianit dhe përhapen gjerësisht në antiklinalin e Kavajës, monoklinalin e Thartorit, etj. Përgjithësisht veçohen katër pako që nga poshtëlart janë: (a) Pako ranoro-argjilore me ndërshtresa gëlqerorësh litotamnik. Trashësia është rreth 250 m. (b) Pako ranoroargjilore. Trashësia është deri 800 m. (c) Më sipër vendoset një pako argjiloalevrolite. Trashësia 150-600 m. (d) Në pjesën e sipërme të prerjes takohet pakoja e argjilave gipsmbajtëse. Trashësia është rreth 500 m.



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	37 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

#### 4.6 INFORMACION MBI PRANINE E BURIMEVE UJORE

##### 4.6.1 BURIMET UJORE SIPERFAQESORE

Pozita gjeografike e zonës në studim, si pjesë përbërëse e Ultersires Bregdetare, relievi kodrinor. Vargmalet që e rrethojnë dhe e mbrojnë nga ererat e ftohta kontinentale, etj. Janë ndër faktorët kryesorë, të përgjithshëm e local, që kushtezojnë vecorite klimatike të zonës tone. Sikundër dhe Ultërsira bregdetare edhe rajoni ynë gjendet në ndikimin e fuqishëm të Adriatikut, sidomos në shpejtësinë e erës edhe regjimit të saj karakteristik gjatë stinës së verës. Nga pikepamja hidrologjike, rajoni ynë ben pjesë në pellgun e madh artesian i cili është i pasur me ujë nentoksore dhe burime sipërfaqesore.

Ushqimi kryesor i rrjetit hidrografik janë reshjet e shiut, gjë kjo që shprehet edhe në vecorite e regjimit të rrjedhës vjetore. Në stinën e verës, prurja e perrenjeve pakesohet aq shumë, sa që një pjesë e tyre që e furnizojnë thahet plotësisht. Kjo vjen nga mungesa e reshjeve gjatë verës, por edhe nga burimet shumë të pakta e të vogla nentoksore, për shkak të përhapjes së formacioneve të papërshkueshme.

Në këtë zonë ndodhet pranë lumi i Tiranës, i cili mund të konsiderohet si burim serioz, por ka edhe prani të perrenjeve të vegjël të cilët le të themi nuk mund të quhen si burime serioze pasi jetegjatesia e tyre varet nga reshjet e shiut.

Referuar dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Ujit, Tirana përfshihet në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen dhe Ishëm, i cili formon një basen të vetëm ujor nga gjashtë në total që ka vendi.

**Ishmi** formohet nga bashkimi i ujërave të lumit të Tiranës, lumit të Terkuzës dhe lumit të Zezës, ndër të cilët si degë kryesore konsiderohet lumi i Tiranës. Pellgu i tij ujëmbledhës pozicionohet në Shqipërinë e mesme ndërmjet pellgut të Matit në veri dhe pellgut të lumit Erzen në jug, vijë ujëndarëse me të cilin kalon nëpër malet Micaku i Shënmerisë ( 1828 m ) dhe atë të Dajtit ( 1612 m ). Ai ka një sipërfaqe prej 673 km<sup>2</sup> me lartësi mesatare 357m mbi nivelin e detit, ndërsa gjatësia e shtrimit është 79,2 km. Në përgjithësi, të tre degët kryesore të tij dhe që rrjedhin në territorin e bashkisë Tiranë, ruajnë karakteristikat e përrenjve malorë me rrjedhje të rrembyeshme gjatë plotave dhe me kohardhje të vogël.

**Lumi i Tiranës** ka një gjatësi rreth 35 km dhe në pjesën e sipërme të tij formohet nga tre degë : Përroi i Mojsitit, Selitës dhe Zall - Bastarit. Në largësi 2.5 km nga qendra e komunës Zall - Dajt ai ndërron emrin dhe quhet lumi i Tiranës dhe vazhdon me këtë emërtim deri në afërsi të fshatit Larushk ku bashkohet me lumin e Terkuzës dhe formon lumin e Gjoles . Degët kryesore të lumit të Tiranës janë: përroi i Lanës, i cili përshkon Tiranën nga verilindja në jugperëndim, ka një gjatësi prej 29km, sipërfaqe ujëmbledhëse 67 km, lartësi mesatare 179 m mbi nivelin e detit dhe rënie 24 m / km; dhe ai i Limuthit i cili ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 31 km. Lumi i Tiranës furnizohet me ujë nga Selitës dhe të disa përrenjve më të vegjël me karakter stinor që derdhen në shtratin e tij.

**Lumi i Terkuzës** rrjedh në veriperëndim të Tiranës dhe në afërsi të Fushe Prezes bashkohet me lumin e Tiranës . Ai buron në pjesën veriperëndimore të Malit me Gropa dhe ka një gjatësi rreth 44.1 km. Pellgu i tij ujëmbledhës ka sipërfaqe 182 km, lartësi mesatare 458 m mbi nivelin e detit dhe rënie 22m / km. Përpara ndërtimit të rezervuarit të Bovillës, shtimi i rrjedhës së lumit gjatë stinës së dimrit dhe pranverës shkaktonte përmytje të shumta. Me ngritjen e rezervuarit të Bovillës dhe disiplinimin e shtrimit me prita e argjinatura ujrat e lumit të Terkuzës janë shfrytëzuar dhe shfrytëzohen për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës.

**Lumi i Zezës** ka një gjatësi të përgjithshme prej 29 km. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 71,3km, ndërsa lartësia mesatare 487 m mbi nivelin e detit. Lumi i Zezës dallohet për regjim torrencial ( të rrembyer ) dhe e siguron 68 % të ujit nga reshjet që bien në pellgun ujëmbledhës të tij. Prurja mesatare shumëvjeçare e tij është  $Q = 2,15 \text{ m}^3 / \text{s}$  ndërsa koeficienti i rrjedhës është 0.68 dhe për këtë arsye, në rast të prurjeve të mëdha, lumi i Zezës shkakton përmytje në zonat e ndodhura pranë brigjeve të tij. Ndërtimi litologjik i pellgut ujëmbledhës të Ishmit favorizon krijimin e një rrjedhe të fuqishme nëntoksore, e cila përfaqëson 40% të rrjedhës së tij vjetore. Ujërat e lumit Ishëm përdoren kryesisht për ujë. Lumi Erzeni përfaqëson një nder lumenjtë e rëndësishëm që përshkojnë pjesën qendrore të vendit. Pellgu i lumit Erzen me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 760 km, zhvillohet në zonën malore në lindje dhe juglindje të Tiranës dhe ka një lartësi mesatare 435 m mbi nivelin e detit . Erzeni buron në afërsi të Qafës së Gurakuqit, në kuotën 1300 metrmbi nivelin e detit dhe ka gjatësi të përgjithshme 109 km dhe prurje mesatare vjetore 18.1 m<sup>3</sup> / s me një modul të prurjes prej 24 l / s / km<sup>2</sup>. Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore për të gjithë pellgun e Erzenit është  $a = 0,51$ .

Si pasojë e ndërtimit gjeologjik të pellgut të tij ujëmbledhës, formacione të papërshkueshme në 60 % të sipërfaqes, gjysëm të përshkueshme në 5% të saj dhe 35% e mbetur nga formacione të

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	38 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

papërshkueshme, ushqimi nëntokësor perfaqeson 31% të rrjedhjes vjetore, ndërsa ai sipërfaqesor 69 % të saj.

Ujërat e lumit Erzen janë përdorur dhe perdoren kryesisht për vaditje dhe shumë pak për ujë të pijshëm ( pas depurifikimit ). Përgjatë luginës së tij ka shumë puse të cekët uji që përdoren për furnizimin me ujë në zonat rurale.

**Liçeni i Paskuqanit** është një prej resurseve më të rëndësishme ujore të Bashkisë së Kamzës. Ai zë një sipërfaqje prej 90 ha dhe aktualisht zona përreth liçenit është zënë nga banesa informale të ndërtuara pas viteve '90, por numri i tyre është i pakët. Ky liçen mund të marrë një rëndësi të veçantë, pasi në drejtim të tij shkon zgjatimi i bulevardit qendror të kryeqytetit dhe egziston një projekt mjaft ambicioz për ta shndërruar zonën përreth liçenit në një park të madh, të gjelbër me karakter pushues e argëtues. Sipërfaqja e ujë mbledhësit është zvogluar si rezultat i rënies së sasisë së prurjeve, ndërtimet informale si dhe humbjes së funksionalitetit për të cilin është ndërtuar.

Pasqyra ujore është variable dhe është në korelacion me sasinë e rreshjeve, dhe mos funksionit të kanalit të furnizimit të tij me ujë. Aktualisht, ky rezervuar është kthyer në një pellg ujëmbledhës ku pothuajse gjatë gjithë vitit qëndron në kuotën "niveli i vëllimit të vdekur".

#### 4.6.2 UJRAT NENTOKESORE


Në pikëpamje hidrogeologjike, territori i Bashkisë Tiranë shtrihet mbi akuiferin e zhavorreve të Kuaternarit të Tiranës, i cili përfaqëson zonën e ushqimit të pellgut të madh ujëmbajtës të Tiranë -Ishmit. Në këtë pellg , horizonti kryesor ujëmbajtës përfaqësohet nga depozitimet e zhavorreve me përhapje në të gjithë zonën ku shtrihet qyteti i Tiranës, Kombinati, Yzberishi, Mezezi, Laknasi, Valiasi etj. Trashësia e këtyre depozitimeve rritet nga qyteti në drejtim të Selitës së Vogël, Kombinat, Mezez - Laknasi, Trashësia e shtresës ujëmbajtëse varion nga 2-3 m, në 5-10 m, trashësi më të madhe ka në sektorët Selitë e Vogël, Unaza e Re, Kombinat, Mezez Laknas . Shtresa ujëmbajtëse ka tregues të mirë hidraulikë, prurja specifike varion nga 2-5 l/sek/m deri në 10-20 l/sek/m, koeficienti filtrimit varion nga 50-100 m/ditë në 200-400 m/ditë.

Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit të zhavorreve të kuaternarit varion  $k = 0.85 - 0.95$  ndërsa sasia e ujit që shfrytëzohet është  $Q = 1200 - 1300$  l/sek dhe përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës, Kamzës dhe qendra të tjera të banuara dhe si ujë teknologjik. Për sa i përket karakterit të ujrave nëntokësore të këtij pellgu , takohen kryesisht ujera pa presion ( qyteti i Tiranës, Laprakë etj.) dhe me presion, por pa vetërrjedhje (Kombinat, Selite, Laknas). Ujrat nëntokësore të pellgut Tiranë ushqehen nga infiltrimet e reshjeve atmosferike, në veçanti kur ato janë pa presion, si dhe nga infiltrimet e ujrave sipërfaqësore të lumenjve Tiranë, Terkozë. Vetitë fiziko - kimike të ujrave janë të mira me  $Mp = 0.5 - 0.08$  mg/l. Nga analizat e kryera rezulton se janë ujëra neutrale, jo agresive ndaj hekurit dhe betonit

#### 4.6.3 REZERVUARET

Ujërat sipërfaqësore të Tiranës përfshijnë edhe një numër të konsiderueshëm rezervuarësh dhe ujëmbledhësish. Liçeni artificial i Tiranës, ndërtuar në parkun më të madh të qytetit, me thellësi prej 12,5 m, sipërfaqe 0,40 km dhe lartësi 116,9 m mbi nivelin e detit. Liçeni artificial ushqehet kryesisht nga pellgu i tij shimbledhës dhe ka një kapacitet prej 2.500.000 m uje. I ndërtuar fillimisht për furnizim me ujë industrial të ish Kombinatit të Tekstileve, me fillimin e furnizimit me ujë nga liçeni i Farkës, ai filloi të përdorej për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në kodrat e Selites dhe Yzberishit . Aktualisht pellgu shimbledhës nuk e siguron mbushjen me ujë në nivelin maksimal për gjithë vitin hidrologjik. Përveç kësaj traseja e shkarkuesit egzistues nuk është në gjendje pune. Rezervuari i Paskuqanit, ndërtuar në vitin 1983 me dy diga, Paskuqan 1 dhe 2. Volumi i ujit që mbledh rezervuari është 9 Mm. Sipërfaqja e ujitur nga ky rezervuar në fillimet e tij ka qenë 2500 ha por në ditët e sotme kjo sipërfaqe është afërsisht 150 ha. Rezervuari i Puzit , ndërtuar në vitin 1971 me volum uji 1.5 Mm. Sipërfaqja e tokave të ujitura prej tij ka qenë afërsisht 500 ha ndërsa në ditët e sotme është më e vogël, por nuk është vlerësuar akoma saktësisht. Rezervuari i Kasharit, ndërtuar në vitin 1963 me volum uji 1.8 Mm. Sipërfaqja e tokave të ujitura prej tij ka qenë afërsisht 500 ha. Rezervuari i Çekrezës, ndërtuar në vitin 1968 me volum uji 4.8 Mm. Sipërfaqja e tokave të ujitura prej tij fillimisht ka qenë afërsisht 1600 ha ndërsa aktualisht është rreth 300 ha. Rezervuari i Farkës, ndërtuar në vitin 1984 me volum uji 9.0 Mm.

Figura 3: Harta e baseneve ujore në Shqipëri



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	40 of 65
--	----------------------	------------	-------	----------

## 4.7 INFORMACIONE PER ELEMENTE TE TJERE TE MJEDISIT

### 4.7.1 Ndotja e ajrit

Me ndotje të ajrit duhet kuptuar prania apo ndërfutja e lëndëve kimike, substancave e materialeve biologjike në atmosferë, të krijuara nga aktivitetet njerëzore ose proceset natyrore, që shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ndotësit e ajrit mund të klasifikohen si primare dhe sekondare.

*Ndotësit primarë* quhen ato substanca që emetohen direkt në atmosferë si: monoksidi i karbonit (CO, i emetuar nga automjetet e vjetra) dhe dioksidi i sulfurit (SO<sub>2</sub>, i lëshuar nga oxhaqet e fabrikave). Ndotësit primarë më të mëdhenj janë:

- Oksidet e sulfurit (SO<sub>x</sub>), veçanërisht dioksidi i sulfurit SO<sub>2</sub>, i cili prodhohet nga procese të ndryshme industriale. Qymyrguri dhe nafta kanë në përmbajtje të tyre përbërës të sulfurit, i cili gjatë djegies gjeneron SO<sub>2</sub>. Oksidimi i mëtejshëm i SO<sub>2</sub>, zakonisht në prani të katalizatorit (NO<sub>2</sub>), formon acidin sulfurik H<sub>2</sub>SO<sub>4</sub>, që shkakton shiun acid.
- Oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), veçanërisht dioksidi i azotit, i cili paraqitet me ngjyrë të kuqërremtë në të kafentë, me erë djegëse dhe shpuese. Ai emetohet nga djegia e materialeve të ndryshme në temperatura të larta. Krahas tij janë edhe Monoksidi i karbonit (CO) dhe dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>).

*Ndotësit sekondarë* janë gazra që zakonisht nuk emetohen direkt, por ato formohen në ajër, kur ndotësit primarë veprojnë ose ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Zonat më problematike janë hapësirat e ish-ndërmarrjeve industriale, të cilat sot janë jashtë përdorimit të nevojshëm dhe të efektivitetit. Një pjesë e ndërmarreve janë privatizuar dhe vazhdojnë aktivitetin e tyre industrial brenda një zone tashmë urbane. Emetimet e ndërmarreve në ajër janë të rrezikshme për banorët e zonës. Emetimet e plumbit, oksid sfulurit, oksid azotit etj, kanë rritur sasinë e ndotësve në ajër.

Mbyllja e shumë prej industrive të Tiranës ka pasur një efekt pozitiv përsa i takon cilësisë së ajrit. Megjithatë, zhvillimet ekonomike dhe sociale pas vitit 1991, veçanërisht rritja e numrit të automjeteve dhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje serioze të ajrit në qytet. Ndërtimi kontribuon në një masë të madhe në përkeqësimin e cilësisë së ajrit qytetin e Tiranës. Ndërtimi rrit gjithashtu dhe ndotjen nga automjetet, si rezultat i qarkullimit të shumë automjeteve të renda. Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, dhe për indikatorë gaztë NO<sub>2</sub> dhe O<sub>3</sub> të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta.

*Përmbajtja e ndotësve të gaztë (NO<sub>2</sub>).*

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit, si duket dhe nga grafiku i mëposhtëm, ajri urban në qytetin e Tiranës në përgjithësi rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë (NO<sub>2</sub>), pasi vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të normës Shqiptare dhe standartit të BE (Figura 20).






Figure : Vlera vjetore e NO<sub>2</sub> (Burimi: AKM)




Fig: Perhapja e shkarkimeve per ndotesit kryesor (PM10,NOx, PB, SO2, etj)Burimi AKM

#### Ndotësit Fotokimik

Në shumë mjedis urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësve primarë dhe përbërësve të tjerë të atmosferës.

Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.

Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës

Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.




Figure : Vlera vjetore e O3

Përsa i përket vlerave vjetore të O3, keto vlera janë brenda normave të lejuara nga standarti Shqiptar Burimi kryesor i ndotjes me NO2 lidhet me numrin e lartë të makinave të vjetra në Shqipëri, me mungese të katalizatorëve nëpër makina dhe cilësia e ulët e karburanteve.

#### 4.7.2 Ndotja akustike

Ndotja akustike i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dBA (në zonat të dendura të trafikut rrugor). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor "i dukshëm". Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Ndotja akustike ka efekte negative mbi shëndetin, në të njëjtën kohë direkte dhe të grumbulluara (të akumuluar).

Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallojë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB).

Niveli i zhurmave urbane (LAeq): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Monitorimi i zhurmave urbane kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka për qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 8 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë

	Emertimi Dokumentit:	<b>RAPORT VNM</b>	Page:	43 of 65
--	----------------------	-------------------	-------	----------

që të gjykohet mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës bezdisen.

Nga monitorimi i zhurmave urbane rezulton se në të gjitha qytetet, kemi nivele të larta zhurmash për periudhën gjatë ditës.



#### **4.7.3 Rreziku Sizmik**

Departamenti i sizmologjisë në mbledhjen e datës 29/01/2021, bazuar në VKM Nr. 1162, datë 24/12/2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi", diskutoi për rezultatet e deritanishme të vlerësimit të rrezikut sizmik të Shqipërisë të prezantuara nëpërmjet hartave përkatëse probabilitare.

Departamenti morri në shqyrtim rezultatet e studimit të realizuar në kuadër të projektit të NATO "SPS 984374", 2012-2015, me titull "Përmirësime të hartave të harmonizuara të rrezikut sizmik të vendeve të Ballkanit Perëndimor", me autorë, për palën shqiptare: Prof. N. Kuka, Prof. Ll. Duni, Prof. Acos. R. Koçi, Dr. E. Dushi, Dr. E. Begu dhe Msc. Rr. Bozo. Hartat e rrezikut sizmik të formuluar nëpërmjet metodologjisë probabilitare në kuadër të projektit të sipërpërmendur janë ripunuar në periudhën Janar-Mars 2020 nga Prof. Neki Kuka, duke aplikuar dy modele të reja të prognozimit të lëkundjes së truallit. Analiza e të dhënave në periudhën Janar-Mars 2020 është realizuar me paketën e programeve NSHM2014r (<https://github.com/usgs/nshmp-haz-fortran/>) të Shërbimit Gjeologjik Amerikan, të cilët janë përdorur për të gjeneruar hartat e përditësuara (2014) të Modeleve Kombëtare të Rrezikut Sizmik (NSHM - National Seismic Hazard Models) për SHBA (<http://pubs.usgs.gov/of/2014/1091/>). Hartat probabilitare të Shqipërisë të prezantuara në Departamentin e Sizmologjisë janë rezultat i ponderimit të hartave të përfutuara nga projekti i NATO "SPS 984374", 2012-2015, të llogaritura me anë të programit OHAZ (program i IGJEUM-it në bashkëpronësi me ARSO, Agjensia e Mjedisit e Sllovenisë), me ato të gjeneruara nga analiza e të dhënave me paketën e programeve NSHM2014r.

Pasi diskutoi për materialet e paraqitura, Departamenti vendosi:

1. Të rekomandojë për përdorim për qëllime të projektimit të strukturave në territorin e vendit tonë hartat probabilitare të rrezikut sizmik të Shqipërisë të hartuara në periudhën Janar-Mars 2020, përkatësisht, atë me probabilitet tejkalimi 10% në 50 vjet (periudhë përsëritje 475 vjet) dhe probabilitet tejkalimi 10% në 10 vjet (periudhë përsëritje 95 vjet) dhe t'i publikojë ato në faqen web të IGJEUM-it. Këto harta do të jenë në përdorim deri në finalizimin e një projekti për përditësimin e tyre sipas të dhënave më të fundit të tërmeteve në vendin tonë dhe rreth tij.
2. Bashkë me hartat probabilitare të rrezikut sizmik, të publikohen edhe vlerat e rrezikut sizmik në terma të PGA për periudha përsëritje 95 dhe 475 vjet, për çdo Bashki dhe Njësi Administrative të vendit. Këto vlera përfaqësojnë parametrin agR sipas standardit të Eurokodit 8.
3. Të rekomandojë që, si spektra elastikë horizontale dhe vertikale në të gjithë territorin e vendit të përdoren format spektrale standarde të Eurokodit 8 të Tipit 1, të shkallëzuara me vlerat përkatëse të rrezikut sizmik për të dy nivelet e rrezikut dhe të përzgjedhura në vartësi të Tipit të Truallit që rezulton nga matjet direkte në vendin ku do të ndërtohet.



Vlerat PGA sipas Njesive Administrative per Qarkun Tirane

Bashkia	Njesia Administrative	Propabiliteti Tejkalimit	
		10% ne 10 vjet	10% ne 50 vjet
Kamez	Kamez	0.139	0.288
	Paskuqan	0.142	0.291
Tirane	Tirane	0.144	0.293
	Petrole	0.15	0.302
	Farke	0.148	0.298
	Dajt	0.144	0.291
	Zall Bastar	0.14	0.281
	Berzhite	0.157	0.315
	Krrabe	0.161	0.323
	Baldushk	0.148	0.3
	Shengjergj	0.156	0.309
	Vaqarr	0.143	0.294
	Kashar	0.14	0.29
	Peze	0.142	0.292
	Ndroq	0.14	0.292
	Zall Herr	0.14	0.287

## 5. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT

### 5.1 METODOLOGJIA PER IDENTIFIKIMIN DHE ANALIZEN E NDIKIMEVE

Përshkrimi i një ndikimi të mundshëm përfshin një vlerësim të karakteristikave të tij, së bashku me atributet e mjedisit pritës. Karakteristikat perkatese të ndikimit përfshijne nëse ndikimi është:

- ✓ Negativ apo i dobishëm;
- ✓ I drejtpërdrejtë ose i tërthortë;
- ✓ Afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë në kohëzgjatje; dhe i përhershëm ose i përkohshëm;
- ✓ Me ndikim në shkallë lokale, rajonale ose globale; përfshirë edhe ndikimin ndërkufitar; dhe
- ✓ Kumulative (Një ndikim kumulativ është "ndikimi në mjedis që rezulton nga rritja e ndikimit të një veprimit, kur shtohet mbi veprime të tjera të ndodhura në të kaluarën, tashmen apo dhe të veprimeve të arsyeshme të parashikuara të ndodhin në të ardhmen").

Secila nga këto karakteristika është diskutuar për çdo ndikim. Marrja në konsideratë e treguesve të mësipërm jep një ndjenjë të intensitetit relativ të ndikimit. Ndjeshmëria e mjedisit pritës u përcaktua nga specialistët bazuar në të dhënat bazë të mbledhura gjatë studimit.

Çdo ndikim është vlerësuar duke përdorur kriteret e renditura në Tabelën 9. Për të siguruar një ilustrim relativ shkalle së ndikimit, është e dobishme që të caktohen përshkrues numerike ose relativë të intensitetit të ndikimit dhe ndjeshmëria e receptorit për çdo ndikim të mundshëm. Secili kriter është vlerësuar në një shkallëzim numerik 1, 2, 3, ose 4, që korrespondon me nivelet: shumë të ulët, të ulët, të mesëm ose të lartë. Shkalla (ashpërsia) e ndikimit është llogaritur më pas si produkti i dy përshkruesve numerike, duke e përshkruar shkallen (ashpërsinë) e ndikimit si të papërfillshme, të vogël, të moderuar apo të madhe. Kjo është një metodë cilësore e projektuar për të siguruar një renditje të gjerë të ndikimeve të ndryshme të një projekti. Në Tabelën 9 janë dhënë ilustrime të llojeve të ndikimit që marrin vlera të ndryshme të ashpërsisë.

Tabela : Klasifikimi i vleresimit të ndikimeve në mjedis

	Klasifikimi	Përshkrimi
1	<b>Shtrirja:</b>	Vlerësimi i zonës së shfaqjes/influences të ndikimit mbi mjedisin në fjale; nëse ndikimi do të ndodhë në vend, në një zonë të kufizuar (brenda një rrezeje prej 2 km nga vendi i projektit); në nivel lokal (brenda një rrezeje prej 5 km); rajonal (nivel qarku, kombëtar ose ndërkombëtar).
2	<b>Vazhdimësia/ Kohezgjatja:</b>	Vlerësimi i kohëzgjatjes së ndikimit në mjedis, nëse ndikimi ka qenë i përkohshëm (<1 vit); afat-shkurtër (1 - 5 vjet); afat-mesëm (5 - 10 vjet); afatgjatë (> 10); ose i përhershëm.
3	<b>Konteksti social / Ndjeshmeria ose Potenciali për konflikt ndermjet aktorëve:</b>	Vlerësimi i ndikimeve për receptorët e ndjeshëm në aspektin e ndjeshmërisë ekologjike, sociale dhe aspekteve të tilla si specie të rralla dhe të rrezikuara, mjedise sensitive ekologjike dhe të rrezikuara, arkitekturë, mjedis shoqëror ose kulturor, potencial i madh për konflikte interesash të aktoreve të ndryshëm. Klasifikimi i ndjeshmërisë është paraqitur më poshtë:  <i>Ndjeshmëri e larte:</i> Zhvendosje e gjithë komunitetit, shkatërrim i trashëgimisë botërore apo vendeve të rëndësishme kulturore, konflikt në shkallë të madhe të grupeve të interesit, etj  <i>Ndjeshmëri Mesatare:</i> Zhvendosja e disa familjeve, niveli i moderuar i shqetësimit të palëve të interesuara

		<i>Ndjeshmëri e ulët:</i> Nuk janë te nevojshme zhvendosjet, nuk ka potencial për konflikt të palëve të interesuara.
<b>4</b>	<b>Pajtueshmëria me kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullator</b>	<p>Vlerësimi i ndikimit ndaj kërkesave ligjore kombetare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>E lartë:</i> Shkelje të mëdha të kërkesave rregullative që mund të rezultojnë në ndjekje penale ose vonesa të mëdha në miratimin e projektit.</p> <p><i>Mesatare:</i> Shkelje potenciale të kufijve specifike të kuadrin rregullator që mund të rezultojnë në mospërputhje.</p> <p><i>E ulët:</i> Nuk parashikohen shkelje të kufijve të veçantë të kuadrin rregullator.</p>
<b>5</b>	<b>Vlerësimi i Ndikimit në përgjithësi (Rëndësia):</b>	Duke përdorur një kombinim të kriterëve të mësipërme, rëndësia e përgjithshme e ndikimit është kategorizuar si: shumë e madhe, e moderuar, e vogël dhe e papërfillshme. Referojuni Tabelës 9 për kategoritë specifike të ndikimit për secilin vlerësim.

Shënim: Këto janë vetëm udhëzime që do të përbëjnë gjykimin profesional që kërkohet në çdo rast individual.

Rëndësia e ndikimit është përcaktuar nepërmjet nje matrice të rëndësise se ndikimit (Tabela 10) e cila krahason peshën e ndikimit me probabilitetin e ndodhjes së tij. Kriteret e rëndësisë se ndikimit janë si më poshtë:

- ✓ Shumë i Lartë (VH) dhe i lartë (H): Këto tregojnë se ndikimi është i papranueshëm dhe se duhet të zbatohen masa të tjera zbutëse për të zvogëluar rëndësinë. E ngjyrosur me ngjyrë të kuqe në tabelën 10.
- ✓ Mesatare (M): Ndikimet në këtë rajon konsiderohen të tolerueshme por duhet të bëhen përpjekje për të reduktuar ndikimin në nivele që janë aq të ulëta sa gjykohen si praktikisht të arsyeshme. E ngjyrosur me ngjyrë të verdhë në matricën e rëndësisë së ndikimit.
- ✓ E ulët (L): Ndikimet në këtë rajon janë konsideruar të pranueshme. E ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër.

Tabela :Percaktimi i rëndësise se ndikimit

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët	E ulët	Mesatare	E lartë
			1	2	3	4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 I papërfillshëm	2 I vogël	3 I vogël	4 I vogël
	E ulët	2	2 I vogël	4 I vogël	6 I moderuar	8 I moderuar
	Mesatare	3	3 I vogël	6 I moderuar	9 I moderuar	12 I madh
	E lartë	4	4 I vogël	8 I moderuar	12 I madh	16 I madh

Efektet kumulative vihen re kur kushtet socio-mjedisore janë tashmë ndikuar nga zhvillimet e kaluara ose me shumë të ngjarë do të ndikohen nga zhvillime apo aktivitete që është e mundshme të zhvillohen në të ardhmen. Në këtë VNM janë identifikuar aktivitete të së kaluarës, aktuale, dhe aktivitete të ngjashme që mund të komplikojnë kushtet socio-mjedisore në zonën e projektit.

Masat zbutëse janë planifikuar për të shmangur, reduktuar, zbutur apo kompensuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale dhe janë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM).

## 6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE POTENCIALE MJEDISORE DHE SOCIALE

Në këtë kapitull, parashikohen dhe analizohen ndikimet e mundshme pozitive dhe negative gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit **“RISHIKIM I PLANIT TE PERGJITHSHEM VENDOR NJESIA STRUKTURORE KZ\_UB\_AR3\_14/315, KZ\_UB\_IS2\_14/316, KZ\_UB\_AS2\_14/196 DHE KZ\_UB\_A2\_14/427”**. Analiza e ndikimit do të përfshijë përcaktimin e madhësisë, masës, kohëzgjatjes dhe rëndësinë e ndikimeve të mundshme. Në seksionet e mëposhtme është paraqitur një vlerësim i detajuar i ndikimeve të pritshme.

### 6.1 NDIKIMET NE MJEDIS

#### 6.1.1 NDIKIMI MBI BIMESINE DHE FAUNEN

##### *Faza e ndërtimit*

Zona e projektit, megjithëse nuk ka një florë të pasur, përmban disa shkurre dhe bimë të tjera, kryesisht të mbjella nga vete banoret pasi zona është e banuar dhe me ndërtime urbane dhe infrastrukture rrugore.


Bimesia e verejtur në zonën e projektit është bimesi e mbire e cila duhet të hiqet për shkak se demton themelet dhe strukturat mbajtëse të objekteve .



Bazuar në kriteret e përcaktuara, ky ndikim mund të përkufizohet si: negativ, i drejtpërdrejtë, lokal, afatgjatë, me mundësinë e ndodhjes - me siguri, i pakthyeshem, me madhësi të lartë dhe rëndësi të moderuar (ndikimi mund të zbutet dhe menaxhohet pjesërisht).

##### *Faza e funksionimit*



Gjatë fazës së funksionimit nuk priten ndikime të rëndësishme negative në bimësinë e zonës.



Ndikimet gjatë fazës së funksionimit ka të ngjarë të jenë lokale. Rëndësia konsiderohet të jetë e ulët.















Fig: Mbulesa e Tokes se zones se projektit

### 6.1.2 NDIKIMI NE GJEOLGJINE E ZONES

#### Faza e ndërtimit

Ndërhyrja në kuadër të këtij projekti përfshin disa aktivitete të cilat do të ndikojnë në gjeologjinë e zonës. Nderhyrjet parashikojne hapjen e themeleve dhe germime. Keto germime do te behen me nje pjerresi te caktuar ne funksion te raportit gjeologjik. Gjate ketyre germimeve ne zona te caktuara mund te kete dhe shkarje per te cilat kontraktori duhet te marre masa dhe ti menaxhoje ato.

Bazuar në kriteret e përcaktuara, ky ndikim mund të përkufizohet si: negativ, i drejtpërdrejtë, lokal, afatgjatë, me mundësinë e ndodhjes - me siguri, i pakthyeshem, me madhësi të lartë dhe rëndësi të moderuar (ndikimi mund të zbutet dhe menaxhohet pjesërisht).

#### Faza e funksionimit

Gjatë fazës së funksionimit ndikimi në gjeologji mund të konsiderohet si i papërfillshëm.

### 6.1.3 NDIKIMI NE HIDROLOGJINE DHE HIDROGJEOLGJINE E ZONES


#### Faza e ndërtimit


Fenomeni i depërtimit të ujit është shumë intensiv, adresimi i këtyre rreziqeve dhe hartimi i një sistemi për mbledhjen dhe hedhjen e ujit ne zona te posacme merr një rëndesi te vecante dhe ka përparësi. Gjatë fazës së ndërtimit nuk do të ketë ndikime të rëndësishme në terma të hidrologjisë dhe hidrogjeologjisë. Punimet që do të kryhen do të jenë ndërhyrje në përmasa të vogla dhe kryesisht mbi tokë.

Nuk do të ketë ndryshime të mundshme në modelet e lëngzimit si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit. Bazuar në kriteret e përcaktuara, ky ndikim mund të përkufizohet si: negativ, i drejtpërdrejtë, lokal, afatshkurtër, me mundësinë e ndodhjes - ka të ngjarë, i pakthyeshem, me madhësi të ulët dhe rëndësi të moderuar (ndikimi mund të zbutet dhe menaxhohet pjesërisht).

#### Faza e funksionimit

Gjatë fazës së funksionimit, ndikimet pritet të jenë më pak të rëndësishme.








Fig: Harta e burimeve ujore

#### 6.1.4 RRRITJA E SASISE TE MBETJEVE

##### Faza e ndërtimit

Punimet për ndërtimin e godinës do të shoqërohen me gjenerimin e mbetjeve të ngurta (inerte). Mbetjet e gjeneruara nga germimet në toke do të risistemohet kryesisht në sheshin e ndërtimit, një pjesë e vogël do të përdoret për mbushje kuote, ndërsa pjesa tjetër së bashku me mbetjet inerte që mund të gjenerohen nga punimet e ndërtimit do të grumbullohen në pika grumbullimi ose vend depozitimi të caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V). Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësine e Qeverisjes Vendore dhe firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet inerte, apo edhe dheu i germuar, materiale të ndërtimit do të trajtohen në mënyrë të veçantë. Mbetjet e ngurta të tjera që prodhohen nga ndërtimi në kantier janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri). Referuar VKM Nr. 402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të Mbetjeve", mbetjet që prodhohen klasifikohen me kodet:

- 20 01 01 Leter dhe karton;
- 20 01 02 Qelq;
- 20 01 39 Plastikët;
- 20 01 40 Metalet;
- 20 02 02 Dhera dhe gure,

Bazuar në kriteret e përcaktuara, ky ndikim mund të përkufizohet si: negativ, i drejtpërdrejtë, lokal, afatgjatë, me mundësinë e ndodhjes - me siguri, i pakthyeshem, me madhësi të ulët dhe rëndësi të moderuar (ndikimi mund të zbutet dhe menaxhohet pjesërisht).

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	55 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

## Faza e Funksionimit

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perdltshe ne kete godine do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike etj. Keto mbetje do te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V dhe firmen pastruese te zones per keto lloj mbetjesh. Grurnbullimi i mbetjeve do te jete i diferencuar dhe te depozitohet nga subjektet grurnbulluese ne Landfill-in e zones.

### 6.1.5 CILESIA E AJRIT

#### Faza e ndërtimit

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet e përkohshme do të shkaktohen në cilësinë e ajrit në zonën nën studim. Këto ndikime janë shkaktuar nga sa vijon:

- ✓ Gërmimet dhe Kanalizimet/ mbushje dhe mbushje
- ✓ Transporti i materialeve që lidhen me fazën e ndërtimit
- ✓ Funksionimi i makinerive dhe mjeteve të punës.

Emetimet e lindura nga trafiku përfshijnë pluhurin dhe tymrat. Emetimet e pluhurit do të dalin nga aktivitetet e ndërtimit dhe trafiku i mjeteve të ndërtimit. Kamionët e përdorur për të transportuar materiale të ndryshme ndërtimi nga burimi i tyre për në sheshin e ndërtimit të objektit emetojnë gazra të ndryshme si SO<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>x</sub> dhe grimca. Ndikimet e emetimeve të tilla mund të jenë më të medha në vendin e ndërtimit dhe në komunitetet ndërmjet te cilave do të udhëtojnë automjetet e ndërtimit. Receptorët e ndikimit përfshijnë komunitetet përgjatë rrugëve të transportit, dyqanet dhe tregjet anës rrugëve, punëtorët e ndërtimit.

Ndotësit e ajrit të emetuar gjatë fazës së ndërtimit mund të klasifikohen në dy kategori. Kategoria e parë lidhet me emetimet e pluhurit, për shkak të punimeve të ndërtimit. Kategoria e dytë përfshin emetimet e shkaktuara nga funksionimi i motorëve të makinerive dhe automjeteve. Emetimet e pluhurit mund të shkaktojnë një problem serioz, veçanërisht kur projekti ndodhet afër zonave të banuara. Megjithatë për shkak të peizazhit të qytetit nuk është e mundur që makinat e rënda t'i afrohen kalasë. Pra, përdorimi i makinave të rënda do të jetë shumë i kufizuar. Në këtë rast nevojiten masat e duhura zbutëse në mënyrë që të minimizohen këto ndikime në mjedis.

Në çdo rast, pavarësisht nga proceset që do të kryhen, cilësia e ajrit nuk do të çënohet jasht standarteve të parashikuara. Kësisoj, pritshmerite jane qe cilesia e ajrit mund te çënohet më shumë gjate procesit te prishjes se ndërhyrjeve të papërshtatshme, dhe gjatë zhvendosjes se mbeturinave të ndërtimit dhe dherave të dale nga gërmimi i trupit të rrugeve, sidomos kur këto procese do të kryheshin në stinën e thatë të verës.

Ne literaturen teknike jepet vlera reference 0.15-0.30 kg/m<sup>3</sup> muaj per clirimet e pluhurave qe perhapen ne mjedis. Keto çlirime mund te konsiderohen te pranueshme. Rikthimi i pluhurit ne toke, ne fakt, supozohet se do te jete shume i vogel dhe do te ndodhe vetem ne zonen prane sheshit të ndërtimit, keshtu qe nuk do te shkaktoje shqetësime mbetese për zonën rretheqark.

Gjatë lëvizjes së automjeteve me naftë, ndotësit më të rëndësishëm të ajrit të emetuar janë si më poshtë: CO<sub>2</sub> nga djegia, CO nga djegia joadekuate, hidrokarburet (HC ose VOC) të cilat krijohen gjithashtu nga djegia joadekuate dhe NO<sub>x</sub> të cilat prodhohen me djegie të lartë temperaturat

Ndotja nga produktet e djegies së motorëve të automjeteve dhe makinerive nuk pritet të jetë e konsiderueshme, kryesisht për shkak të sasive të vogla të emetimeve, të cilat do të prodhohen nga një numër i kufizuar i makinerive. Një rritje e vogël pritet në përqendrimet e ndotësve nga rritja e trafikut gjatë ndërtimit të projektit.

Rritja e përqendrimeve të ndotësve të caktuar do të jetë lokale dhe e përkohshme gjatë punimeve të ndërtimit.

Për ta përmbledhur, ndikimet në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit konsiderohen të jenë lokale, të përkohshme, me një madhësi mesatare negative të ndikimit dhe me një ndjeshmëri të mesme. Ndikimet në ajër mund të minimizohen në të vogla me zbatimin e standardeve përkatëse të punës dhe masave që lidhen me emetimet e makinerive dhe automjetet e vendit të punës.

#### Faza e Funksionimit

Gjatë fazes se funksionimit, ndikimet jane te paperfillshme te shkaktura kryesisht vetem nga mjetet e perdorura per inspektim dhe mirembajtje te zonave te projektit si dhe mbetjet e banoreve te cilat do te sistemohen ne rrjetin ujesjellesit lokal.

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	56 of 65
--	----------------------	------------	-------	----------

### **6.1.6 NDIKIMI NE MJEDISIN AKUSTIK -VIBRIMET**

#### **Faza e ndërtimit**

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e konsiderueshme për një periudhë të kufizuar kohore. Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit (pajisje, mjete, makineri, etj.) mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrave specifike që kryhen. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë. Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë në përputhje me standardet e zbatueshme të BE-së për zhurmën për pajisje të tilla siç gjenden në Direktivën e BE 2000/14 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 8 majit 2000, për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare, në lidhje me emetimet e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim jashtë.

Gjatë fazës së ndërtimit, priten ndikime lokale mesatare negative në zonën e projektit. Zhurma e prodhuar gjatë fazës së ndërtimit do të burojë kryesisht nga funksionimi i mjeteve/pajisjeve/ makinerive të ndërtimit. Zhurma mund të bëhet problem në varësi të distancës së zonës së projektit nga marrësi / receptorët, pasqyrimi i zërit, ekzistenca ose jo e pengesave natyrore dhe artificiale, nga kushtet meteorologjike dhe lloji i sipërfaqes midis zonës së vendit të punës dhe marrësit.

Ndikimet negative nga emetimi i zhurmës gjatë fazës së ndërtimit do të shkaktohen gjatë ditëve dhe orëve të punës dhe veçanërisht gjatë funksionimit të njekohshëm të disa makinerive.

Nivelet e rritura të zhurmës për shkak të punëve të ndërtimit do të jenë afatshkurtra dhe plotësisht të kthyeshme pas përfundimit të punimeve të ndërtimit. Me marrjen e masave të duhura zbutëse, ndikimet e zhurmës mund të reduktohen në një nivel të vogël.

#### **Faza e Funksionimit**

Gjatë fazës operacionale ndikimet janë te paperfillshme, lokale ne funksion te punimeve te mirembajtjes. Me masat e duhura zbutëse, ndikimet e zhurmës mund të rezultojnë në nivele të vogla negative deri në të parëndësishme.

## **6.2 NDIKIMET SOCIALE**

### **6.2.1 NDIKIMI NE TRASHEGIMINE KULTURORE**

#### **Faza e ndërtimit**

Siperfaqja që prek projekti I propozuar, nuk ben pjese ne zone te mbrojtur. Ky informacion eshte gjeneruar nga gjeoportali shteteror: asig.gov.al

Nga verifikimet paraprake me informacionet që disponojme është identifikuar se nuk preken zona të mbrojtura. Distanca që ruan projekti i propozuar, me zonat e mbrojtura të rajonit janë si me poshte të paraqitura ne figure.

Per informacion me te sakte zhvilluesi, ose institucionet aprovuese te projektit mund te paraqesin kerkese per verifikim prane AKZM per verifikime me te detajuara dhe me te sakta.

#### **Faza e Funksionimit**

Nuk ka asnje ndikim ne zonat mbrojtura dhe te trashegimise kulturore

### **6.2.2 NDIKIMI NE ANEN VIZUALE DHE ESTETIKA**

#### **Faza e ndërtimit**

Aktivitetet e ndërtimit do të kërkojnë vendosjen e materialeve, pajisjeve dhe rrethimin e plote ose të pjesshem te zones se projektit.

Kohëzgjatja e ndikimit vizual do të jetë afatshkurtër vetëm gjatë fazës së ndërtimit. Intensiteti i ndikimit do të jetë shumë i ulët duke marrë parasysh gjendjen e rrënuar të të gjitha objekteve ekzistuese; Prandaj, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë e ulët, prandaj do të ketë një rëndësi të vogël të ndikimit.



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	57 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

## Faza e Funksionimit

Projekti do të ketë një ndikim pozitiv në peizazhin dhe vizualitetin. Efekti do të jetë afatgjatë, i moderuar.

### 6.2.3 SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE: RREZIKU PER KONTRAKTORET

Aktivitetet e ndërtimit mund të paraqesin rreziqe potenciale disa prej të cilave mund të jenë të rrezikshme për jetën, për shembull, rënia nga lartësitë mund të jetë fatale nëse punëtorët nuk përdorin rripat e sigurisë kur punojnë në lartësi. Puna me tension të lartë apo puna me nxehtësi (sikurse saldimi), përbëjnë një rrezik për dëmtime nga elektriciteti. Përveç kësaj, rënia e mbetjeve nga lartësitë mund të plagosë punëtorët që janë poshtë në qoftëse nuk përdoren pajisjet personale mbrojtëse (PPM). Lëndime ose dëmtime të shtyllës kurrizore mund të ndodhin në qoftë se punëtorët mbajnë objekte të rënda. Rreziqe të tjera të mundshme mund të jenë: ndriçimi jo adekuat gjatë orëve të nates ose nivel të kufizuar të shikimit gjatë fortunave duke krijuar vështirësi për stafin e makinerive të pajisjeve të rënda, makinave me sistem të papërshtatshëm frenimi, mungese përqendrimi ndërsa punohet dhe ekspozimi ndaj mbetjeve të rrezikshme të tilla si bojrat, çimento, adhezive dhe tretësit për pastrim. Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë afatshkurtër pasi mund të ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërtimit. Shtrirja e ndikimit do të jenë lokale ose kombëtare në varësi të origjinës së punëtorëve.

### 6.2.4 AKSIDENTET

Zona e projektit ndodhet ndodhet e shpërndare në disa zona kryesisht urbane dhe të banuara dhe aksidentet rrugore për shkak të rritje së frekuencës së lëvizjeve të automjeteve që shkojnë në kantier janë të parashikueshme pa harruar rreziqet për punëtorët që mund të vijnë nga rënia poshtë e materialeve apo mbeturinave nga aktivitetet e ndërtimit.

Përsa i përket kohëzgjatjes ky ndikim do të jetë afatshkurtër dhe do ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërhyrjeve. Shtrirja e ndikimit do të jetë lokale ose rajonale në varësi të origjinës së punëtorëve.

### 6.2.5 TË ARDHURA MË TË LARTA PËR KONTRAKTORËT DHE PËR FURNITORËT E MATERIALEVE/PAISJEVE

Zhvillimi i projektit nënkupton punimet civile që kërkojnë materiale të tilla si gure, beton, lëndë druri, hekur dhe çimento. Ky ndikim është pozitiv, por afatshkurtër dhe ndikimi i kthyeshëm. Duke pasur parasysh se puna ndërtimore do të jetë lokale apo kombëtare, ky ndikim ka shtrirje lokale apo kombëtare.

Masat përmirësuese: Lëndët e para (materialet e ndërtimit) duhet të merren vetëm nga subjekte të licencuara. Materialet e ndërtimit të cilat do të jenë në përputhje me specifikimet teknike europiane. Blerja e vetëdijshme ose i paqëllimtë e këtyre materialeve nga operatorë të palicencuar në mënyrë indirekte nxit degradimin e mjedisit në zonat ku janë vendosur këto subjekte të paligjshme dhe mund të shpjerë në ndikime negative afatmesme apo afatgjata. Prandaj, blerja e materialeve të ndërtimit nga guroret e licencuara dhe që operojnë në mënyrë legjitime duhet të jetë një detyrim kontraktual për kontraktorët.

### 6.2.6 PUNËSIMI

Zbatimi i projektit do të hapë një front të ri pune, kryesisht në fushën e ndërtimit gjatë fazës së zbatimit. Masat përmirësuese: Nëse do të jetë e mundur, duhet të konsiderohet mundësia e punësimit të banorëve lokale, kjo në varësi edhe të aftësive të tyre. Për të siguruar një mjedis të favorshëm nevojitet që punonjësit të ju ofrohen standardet përkatëse të shëndetit dhe sigurisë në punë.

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	58 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

## **7. INFORMACION MBI SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS**

### **7.1 SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA**

#### **7.1.1 NDIKIMI NE UJERAT NENTOKESORE**

- ✓ Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura tokën;
- ✓ Makineri në ndërtim dhe kamionet transportues të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.
- ✓ Rreziku i ndikimeve negative në ujin në infrastrukturën furnizuese duke përfshirë periferinë e objektit.

Në zonë nuk ka puse hidrogjeologjike të hapura në akuiferet kuaternare zhavorere për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë, për pasojë nuk ka ndjeshmëri për ndikimin të mundshme të aktiviteteve të projektit në ujërat nëntokësore. Megjithatë marrja e masave për ndalimin e shkarkimeve ndotese është e rëndësishme. Nese nuk merren masa, ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore janë vlerësuar të nivelit të ulët e me probabilitet të moderuar të madhësisë të moderuar.

#### **7.1.2 NDIKIMI NE UJRAT SIPERFAQESOR**

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (punime tokësore dhe kullimit; larja e makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; ndërtimet, etj), përfshijnë:

- ✓ Rritja e pezullive në ujërat të nga germime e dherave;
- ✓ Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta;
- ✓ Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;
- ✓ Erozioni dhe sedimentimi;

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale. Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së operimit.

Gjatë ndërtimit, në varësi edhe të rreshjeve të shiut, mund të grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujërave dhe si rrjedhojë mund të jetë i nevojshëm grumbullimi i këtyre ujërave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimeve, pjesërisht ato filtrojnë nëntokë. Si rrjedhojë, punimet e ndërtimit nuk duhet të tejzgjaten dhe të kalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit.

Nuk duhet të shkarkohen lëndë të dëmshme në mjedisin e kantierit pasi mund të filtrojnë së bashku me ujerat e rreshjeve dhe si rrjedhojë të ndosin ujerat nentokesore. Në kantier nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore. Mundësite e ndotjes, mund të vijnë vetem nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikantëve gjatë furnizimit të mjeteve të rënda të punës.

### **7.2 SHKARKIMET E GAZRAVE DHE PLUHRAVE**

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojnë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Emetimet ne ajer vijnë nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes. Shkarkimet ne ajer mund të specifikohen ne: emetime të pluhurave dhe grimcave (Dust and Particulates) dhe emetime te gazrave dhe tymrave nga makinat (Gaseous and Exhaust Emissions). Emetimet me të medha qe cenojne cilesine e ajrit mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitet ndertimore.

#### **Pluhuri dhe grimcat**

Gjatë ndërtimit, mund të ketë një perkeqesim të përkohshme të cilësisë së ajrit lokal si rezultat i gjenerimit të pluhurit dhe grimcave. Vleresohet qe ky perkeqesim të jetë domethënës, me potencial për të prekur punëtorët në vendndodhjen e projektit. Sidoqoftë, ndikimi në receptorët në terren do të jetë minimale pasi vendndodhja aktuale e projektit nuk ka dendësi të larte banoresh. Krijimi i rrugëve hyrëse, gërmimet dhe punimet tokësore mund të çojë në rritjen e përkohshme të grimcave dhe të pluhurit në ajer nga transporti. Pjesa më e madhe e pluhurit të krijuar gjatë ndërtimit ka të ngjarë të depozitohet brenda 100 metrave nga vendndodhja aktuale e projektit. Në mungesë të të dhënave nga Institucionet Shqiptare, ne përdorim të dhënat nga Agjensia e Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas Dokumentit të Udhëzimit Teknologjik të Agjencisë së Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar, rreth 85% e grimcave në ajrin e ambientit depozitohen brenda 100 metrave të burimit ndërsa afërsisht 10% depozitohen midis 100 dhe 500 metrave

### 7.3 ZHURMAT DHE VIBRIMET

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga përdorimi i vincave të ndryshëm, gjeneratorëve, zhurma e prodhuar nga vetë personat që do të punojnë për këtë kantier, proceset e hedhjes së betonit, përdorimi i skelave dhe dërrasave, pajisjeve të prerjes së hekurit, etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e dëgjimit. Kjo duhet të kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Nuk do të shkaktohen vibrime shqetësuese gjatë punimeve. Këto procese në përgjithësi ndikojnë negativisht në tokë, por vetëm gjatë proceseve ndërtimore. Efekti me i rëndësishëm në tokë është zënia e tokës së lirë me ndërtim të përhershëm dhe humbja e hapësirave të lira e produktive të tokave bujqësore. Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj.

Vibrimi (Dridhja) është lëvizja periodike e masës me kalimin e kohës. Ndërtimi i veprave të projektit të propozuar ka potencial të gjenerojë dridhje që do të përjetohen nga strukturat e afërta dhe banorët e tyre. Funkcionimi i pajisjeve të rënda ndërtimore (të tilla si prerësit e pllakave të trotuarëve) krijojnë valë sizmike që rrezatojnë përgjatë sipërfaqes së tokës dhe poshtë në tokë. Këto valë sipërfaqësore mund të ndjehen si dridhje në tokë. Dridhja nga funksionimi i kësaj pajisje mund të rezultojë në efekte që variojnë nga bezdisja deri tek dëmtimi i ndërtesave. Dëmtimi i ndërtesave mund të përfshijë dëmtime strukturore (p.sh. plasaritja e pllakave të dyshemesë, themelet, kolonat, trarët ose pusët) ose dëmtimi arkitektonik kozmetik (p.sh. suva e plasaritur, llaç ose pllaka).

Reagimi i njerëzve ndaj vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumë faktorë fizike, si amplituda, kohëzgjatja dhe përmbajtja e frekuencave të vibracioneve, si dhe faktorë të tjerë si lloji i popullsisë, mosha, gjinia dhe pritjet të cilat janë fiziologjike. Sipa kësaj reagimi i njerëzve për vibracionet është subjektiv dhe kjo ndryshon për njerëz të ndryshëm. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Tabela në vijim (Tabela 11) paraqet distancat në të cilën dridhjet mund të jetë të dukshme për lloj të caktuar të aktivitetit të ndërtimit. Këto shifra janë të bazuara në matjet historike në terren dhe nga literatura.

Tabela : Aktivitetet e ndërtimit dhe ndikimi i vibrimeve

<b>Aktivitet e ndërtimit</b>	<b>Distanca (në m) nga ku mund të perceptohet vibrimi</b>
<b>Germimet</b>	<b>10-15</b>
<b>Kompaktesimi, ngjeshja me veprim</b>	<b>10-15</b>
<b>Kamionat e rëndë</b>	<b>5- 10</b>

Për shkak të afërsisë së objekteve të banimit e shërbimeve në afërsi nga vendi ku zbatohet projekti, ka mundësi që dridhjet nga kalimi i mjeteve të rënda të jenë evidente.

### 7.4 PRODHIMI I MBETJEVE

Mbetje të ngurta që prodhohen nga zbatimi i projektit do të jenë të natyrave të ndryshme. Materialet të cilat janë të ripërdorshme, mund t`ju jepen individëve të interesuar për punime ndërtimi në zonat periferike ose rehabilitim të lulishteve ose mbushje të tokave aty ku ka nevojë, pjesa e mbetjeve të pa përdorshme duhet të grumbullohen në vendin e caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes së Lejes së Zhvillimit nga autoritetet përgjegjëse. Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes vendore dhe firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet inerte, apo edhe dheu i gërmuar, materiale të ndërtimit duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Në këtë fazë nuk kemi informacion për mënyrën e menaxhimit të mbetjeve inerte. Landfilli ku do të depozitohen këto mbetje duhet që të jete i pajisur me leje mjedisore dhe i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Mbetjet e rrezikshme nese do të ketë, do të dorezohen sipas kërkesave të VKM Nr. 371 date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit"  
 Vajrat e makinave, nese do te kete, do te dorezohen sipas kërkesave të VKM Nr. 765, date 07.11.2012 "Per rregullat dhe procedurat per asgjësimin e vajrave te perdorur"

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	60 of 65
--	----------------------	------------	-------	----------

Transferimi i mbetjeve jo te rrezikshme do te shoqerohet me plotesimin e Shtojces 1 te VKM Nr. 229 date 23.04.2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"

Baterite e automjeteve klasifikohen si mbetje jashte perdorimit dhe te rrezikshme do te dorezohen sipas VKM Nr. 866, date 4.12.2012 "Per Baterite, akumulatoret dhe mbetjet e tyre"

Te gjitha mbetjet teknologjike do te transportohen nga subjekte te pajisur me licence te tipit III.2.B ne baze te ligjit 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar. Sipas VKM Nr. 575 date 24.06.2015, subjekti fizik/juridik, kerkes i lejes per ndertimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, perpara marrjes se lejes se ndertimit duhet te depozitoje nje garanci financiare per llogari te NJQV-se, e cila nuk do te jete me e vogel se 3% e vleres se strukturës së objektit dhe percaktohet me vendim te keshillit te NJQV-se.

## 8. KOHEZGJATJA E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA

Persa i perket shtrirjes kohore, ndikimi i projektit do te jete tejet i kufizuar. Sikurse eshte theksuar ne seksionet e mesiperme, ku jane marrë ne konsiderate te gjithë elementët mjedisore që mund të preken nga projekti, ndikimi në zonën ku zhvillohet, pritet të jetë minimal.

Ndikimet e fazës ndërtimore do të zgjasin për aq kohë sa zgjasin punimet për ndërtimin. Me përfundimin e fazës së ndërtimit do të merren masa për rehabilitimin e zonës së punimeve. Zonat e gjelbra do të ruhen gjatë ndërtimit, por edhe ajo pjesë që do të demtohen do të zëvendësohet me drure të tjere dhe sipërfaqe të gjelbëruara.

## 9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) për punimet e propozuara në zonën e projektit, identifikon aspektet e mundshme mjedisore dhe sociale që duhet të monitorohen. Ai identifikon palët përgjegjëse për monitorimin, shpenzimet e nevojshme, treguesit dhe nevojat për trajnim apo për ngritjen e kapaciteteve dhe raportimin. Në seksionet më poshtë janë përshkruar në mënyre të detajuar aspekte të ndryshme të PMMS.

### 9.1 MARRËVESHJET INSTITUCIONALE

#### 9.1.1 Strukturat dhe përgjegjësitë institucionale

Përgjegjësia institucionale për zbatimin e kësaj PMMS bie mbi autoritetin Kontraktor. Një ndër rolet kyç do të jetë rishikimi i raporteve të konsulentëve për pajtueshmërinë me PMMS. Role të tjera do të jenë:

- ✓ Monitorimi i zbatimit te veprimeve zbutëse nga kontraktorët
- ✓ Koordinimi i trajnimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve, kur janë planifikuar
- ✓ Raportimi periodik mbi zbatimin e PMM

Autoriteti Kontraktor duhet të sigurojë që i gjithë personeli i saj i përfshirë në zbatimin e këtij PMMS kanë kualifikimin e nevojshem dhe janë emëruar në bazë të kualifikimit dhe përshtatshmërisë së tyre për rolet përkatëse pasi për ta nuk janë parashikuar trajnime në këtë PMMS.

Autoriteti Kontraktor do duhet të kërkojë nga kontraktorët zbatimin e plotë të këtij PMM dhe kontraktorët duhet të caktojnë një specialist Mjedisori i cili do të mbikëqyrë mjedisin gjatë ndërtimit. Megjithatë, në rastin kur kontaktori nuk ka një Specialist Mjedisori, inxhinieri mbikëqyrës apo menaxheri i sheshit të ndërtimit duhet të trajnohet për çështjet e mjedisit të rëndësishme për këtë PMMS në mënyrë që ai të luajë edhe rolet e mbikëqyrjes së çështjeve të mjedisit kur kërkohet. Përveç kësaj Autoriteti Kontraktor duhet të caktojë një specialist të saj për të përfaqësuar objektivat dhe interesat mjedisore të klientit gjatë fazës së ndërtimit. Kriteri bazë i punësimit për një person te tillë është që të ketë një formim në çështjet mjedisore, në veçanti të lidhura me projektet e ndërtimit.

Në Tirane, Inspektorët e mjedisit nga Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) janë përgjegjës për mbikëqyrjen e mbrojtjes së mjedisit në emër të AKM. Ata do të kenë edhe rolin e monitoruesit gjatë zbatimit të këtij PMM. Bazuar në njohuritë e tyre profesionale apo rekomandimet në këtë VNM, zyrtarët lokalë të mjedisit mund të kenë rol në hartimin e projektit, si këshilltarë për inxhinieret konsulentë në aspekte të ndryshme

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	61 of 65
--	----------------------	------------	-------	----------

## 9.2 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrolloje nëse veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qënë efektiviteti i tyre. Monitorimi do të identifikojë edhe ndikimet e paparashikuara që mund të lindin nga zbatimi i projektit.

Kush monitoron dhe si: Monitorimi do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor dhe Inspektorët e Mjedisit të Agjencise Rajonale te Mjedisit (ARM) që përfaqësojnë AKM. Monitorimi nga ARM-ja në këtë rast mund të konsiderohet si "Monitorim nga një palë e tretë", por ky është mandati i saj rregullator në përputhje me VKM Nr 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale te Mjedisit"

Një agjenci qeveritare që mund të ndërmarrë "Monitorimin nga një palë e tretë" është Inspektorati Shtetëror i Punës. Kjo njësi ka autoritetin për të inspektuar cdo strukturë për zbatimin e ligjshmërisë për sigurinë në vendet e punës.

Monitorimi do të bëhet me anë të inspektimit, shqyrtimit të ankesave të regjistruara nga palët e interesuara dhe diskutime "ad hoc" me persona potencialisht të prekur (punëtorët e ndërtimit, banorët pranë zonës së projektit, etj.).

Frekuenca: Monitorimi do të kryhet çdo muaj gjatë gjithë periudhës së ndërhyrjes.

Auditimet: Auditimet do të jene të nevojshme si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë funksionimit të projektit. Ndërsa auditimet e ndërtimit do të synojnë në verifikimin e përputhshmerise me kërkesat për masat zbutëse të ndikimit, auditimet post-ndërtimit janë një kërkesë ligjore dhe duhet të kryhen si rregull brenda 12 muajve por jo më vonë se 36 muaj pas përfundimit të ndërtimit.

Si auditimi gjatë ndërtimit ashtu dhe ai post-ndërtim mund të jenë të brendshem ose te jashtëm (nga një konsulent i angazhuar nga Bashkia). Në këtë PMM është propozuar edhe buxheti përkates, nëse auditimi do të kryhet nga një konsulent i punësuar për këtë qellim.

Raportimi: Autoriteti Kontraktor duhet të hartojë çdo muaj raporte mbi monitorimin. Këto raporte duhet ndahen me palët e interesuara. Bashkia mund ti ndajë raportet e saj të auditimit gjatë fazës së ndërtimeve dhe post-ndërtimit me AKM apo aktorë të tjerë të interesuar por nuk ka asnjë detyrim ti bëjë të ditur auditimet në fazën e ndërtimit.

## 9.3 MEKANIZMI I ANKESAVE

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrolloje nëse veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qënë efektiviteti i tyre.

Ky seksion përshkruan rrugët që mund te ndjekin personat e prekur për të paraqitur ose shprehur një ankesë kundër këtij projekti, stafit të tij ose kontraktorëve gjatë zbatimit të projektit. Ne kete seksion gjithashtu përshkruhen procedurat, rolet dhe përgjegjësitë për adresimin e ankesave dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Çdo person i dëmtuar mundet të nxise këtë mekanizëm për të zgjidhur shpejt ankesat e tij. Objektivat e procesit të ankimit janë:

1. Të sigurojë që janë identifikuar dhe zbatuar te gjitha veprimet e duhura korrigjuese reciprokisht të pranueshme për të adresuar ankesat;
2. Të verifikojë nese personat qe kane paraqitur ankesat janë të kënaqur me rezultatet e veprimeve korrigjuese;
3. Te shmangen perplasjet dhe proceset gjyqësore.

Mekanizmi i ankesave në çdo objekt do të ushqehet nga tre burime kryesore:

- ✓  Banorët e zones/komunitetit.
- ✓  Inxhinieri mbikëqyrës, pergjegjesi i kantierit ose kontraktori.
- ✓  Ekipi monitorues i cili do të përcjellë çështje / probleme të identifikuar në këtë fushë

Hapat e procesit të ankimit janë përshkruar më poshtë. Skema qe përshkruan veprimet kryesore dhe pikat vendimtare është paraqitur në Figurën 18.

### Hapi 1: Pranimi i ankesës

Ankesa verbale apo me shkrim do të merret nga Përgjegjesi i Kantierit dhe do të regjistrohet në librin e ankesave. Ne liber do të shenojnë pakënaqësitë, daten e paraqitjes, veprimin e ndërmarrë për të trajtuar ankesën apo arsyen perse ankesa nuk është marre në konsiderate; informacion i dhënë personit që ka paraqitur ankesën dhe data e mbylljes se ankeses. Ankesat duhet të dorëzohen në çdo kohë direkt në zyrën e Përgjegjesit te Kantierit. Procesi për ankesën jepet më poshtë:

1. Përgjegjesi i Kantierit pranon ankesën (ankesat) nga ankuesi dhe e regjistron atë në liber.
2. Përgjegjesi i Kantierit e lexon ankesën e regjistruar për të konfirmuar cdo detaj i ankesës është dokumentuar.
3. Ankuesi nënshkruan ne lber për të konfirmuar se ankesa është regjistruar me saktësi.

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	62 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

### Hapi 2: Përcaktimi i veprimeve korigjuese

Nëse sipas mendimit të tij / saj, një ankesë mund të zgjidhen në këtë fazë, Përgjegjesi i Kantierit do të përcaktojë një veprim korigjues në konsultim me personin e dëmtuar. Në librin e ankesave duhet të regjistrohen veprimet korigjuese, afati kohor brenda të cilit ata duhet të realizohen dhe pala përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Pas zgjidhjes së ankesës, kjo i behet e ditur ankuesit brenda 5 ditëve. Nëse për zgjidhjen e ankesës nevojitet më shumë kohë kjo do të komunikohet më parë në mënyrë të qartë personit të dëmtuar. Për rastet që nuk janë zgjidhur brenda kohës së përcaktuar, do të ndërmerren hetime të detajuara dhe rezultatet duhet të diskutohen jo më shumë se 1 muaj nga parashtrimi i ankesës.

### Hapi 3. Takim me ankuesin

Veprimi i propozuar korigjues dhe afati kohor në të cilën do të zbatohet ky veprim do të diskutohet me ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës.

### Hapi 4: Implementimi i veprimeve korigjuese

Veprimi korigjues për të cilin është rënë dakord do të ndërmerret nga projekti ose kontraktori brenda afatit të rënë dakord. Data e përfundimit të veprimit do të regjistrohet në librin e ankesave.

### Hapi 5: Verifikimi i veprimeve korigjuese

Për të verifikuar nëse personi që ka bërë ankesën është i kenaqur me reagimin nga ana e projektit, atij do të kërkohet që të kthehet, nëse nuk është i kënaqur me veprimet korigjuese.

### Hapi 6: Veprimet nga Bashkia dhe kontraktorët e projektit

Nëse Përgjegjesi i Kantierit nuk mund të zgjidhë ankesën, ai do ta parashtrijë atë te Bashkia (dhe kontraktori) përmes inxhinierit mbikëqyrës. Besohet që në këtë nivel mund të zgjidhen të gjitha ankesat e mundshme. Procesi që duhet ndjekur për ankesat është paraqitur në Figurën 18.

## 9.4 MASAT PËR SHMANGIEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ne zbatim të këtij projekti do të mbahet në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa korrekte. Cdo zbatim i projektit duhet të shoqërohet me planin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e dëmeve mjedisore të riparueshme.

Masat për mbrojtjen e mjedisit do të planifikohen dhe zbatohen gjatë operacioneve me ndikim në mjedis si në fazën përgatitore ashtu dhe në ato të shfrytëzimit të kësaj sipërfaqeje toke. Në këtë seksion do të trajtohen masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative të identifikuara në seksionet paraardhese. Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetet e mëposhtme:

### 9.4.1 Masat për zbutjen e ndikimeve gjatë fazës përgatitore sipas receptoreve të mjedisit

Nr	Lloji Ndikimit	Masat e propozuara
1	Shqetësim i shtresës së tokës për shkak të ndërtimit	Sasia e dheut mund të sistemohet përgjatë kantierit dhe të përdoret për qëllime rehabilitimi në fazën të ndryshme të shfrytëzimit ose për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara në përfundim të projektit
2	Ngjeshje e pjesshme e tokës nga levizja e automjeteve të transportit	Për parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes do të shfrytëzohen vendet e caktuara
3	Erozion sipërfaqësor në mot me rreshje	Do të hapen kanalet e drenazhimit në sipërfaqe. Në varësi të terrenit dhe kushteve të tokës do të hapen kanale anësore që do të ndalin forcën geryese të ujrave të rreshjeve, ndërsa përgjatë perimetrit të sheshit të depozitimit të mbetjeve inerte do të hapen kanale perimetrike kufizuese që do të frenojnë geryerjen dhe transportin e tokës. Në pjesë të vecanta do të shihet mundësia e mbjelljeve të fidaneve pyjore të pershtatshme për zonën fitoklimatike
4	Ndotja e tokës si pasoje e avarive të mekanikes	Makineritë e transportit do të kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre dhe do të riparohen për defektet e shfaqura.

#### 9.4.2 Masat per mbrojtjen e ajrit

Nr	Lloji Ndikimit	Masat e propozuara
1	Emetimet e pluhurit ,zhurmes,gazeve,aromave dhe vibracioneve	Makinerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem teknologjike dhe jo e avarive.ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate te ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave

#### 9.4.3 Masat per mbrojtjen e peisazhit

Nr	Lloji Ndikimit	Masat e propozuara
1	Ndikime ne peisazh dhe topografine e relievit	Ndertimi ne kete siperfaqe nuk demtojne siperfaqen e relievit. Keto siperfaqe do te rehabilitohen menjehere sapo te mbaroje ndertimi i objektit

#### 9.4.4 Masat per mbrojtjen e biodiversitetit

Nr	Lloji Ndikimit	Masat e propozuara
1	Ndikim ne faune	Shoferet do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit per te mos shtypur kafshe qe mund te jene ne mes te rruges. Ato duhet te kalojne ne rruge te lira.

#### 9.4.5 Masat per administrimin e mbetjeve urbane

Nr	Lloji Ndikimit	Masat e propozuara
1	Gjenerimi i mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen ne vende te posacme. Ato do te transportohen drejt qendrave per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant i perdorur do tu jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne ne shqiperi. Ne fazen e shfrytezimit te vepres mbetjet njerezore do te shkarkohen ne rrjetin e miratuar nga pushteti lokal

#### 9.4.6 Masat per mbrojtjen e tokes nga ndotja dhe demtimi fizik

Transporti i mbetjeve inerte do te behet me mjete transporti kamione. Per vazhdimin si do te pergatitet dhe percaktohet vendi i parkimit te makinerive kryesisht ne siperfaqen e pergatitur me pare dhe nuk do te demtohen siperfaqe te tjera vetem per parkim

Masat ne terren per mbrojtjen e tokes jane:

- Piketimi dhe hapja e kanaleve te drenazhimit ne siperfaqe
- Hapje kanalesh anesore qe do te ndalin forcen gerryese te ujrave te shiut, ndersa pergjate sheshit te depozitimit te inerteve do te hapen kanale periferike kufizuese per te frenuar gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerresise nga ujrat siperfaqesore
- Makinerite do te kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjeset e demtuara do te nderrohen menjehere

Kanalet e drenazhimit pergjate objektit do te mirembahen dhe pastrohen rregullisht sidomos ne stinet me reshje

Kontrolli i erozionit siperfaqesor do te jete nder masat me te rendesishme te mbrojtjes se mjedisit nga aktiviteti i kryer. Masat per kontrollin e erozionit jo vetem qe mbrojne siperfaqen e tokes nga demtimi por indirekt kontribuon ne mbrojtjen e burimeve ujore dhe bimesise se zones

#### 9.4.7 Masat per mbrojtjen e ajrit

Ne veprimtarine e terheqjes, transportit, depozitimit te mbjeteve inerte jane mjetet e transportit si burimi kryesor i ndotjes se ajrit. Per te parandaluar ndotjen e ajrit automjetet do te kualifohen

	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	64 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

periodikisht dhe do te kontrollohen. Perdorimi i naftes me permbajtje te ulet sqfuri ndikon ndjeshem ne ndotjen e ajrit. Njekohesisht mjetet e transportit dhe makinerite e tjera do te jene burim i zhurmave por duke u nisur nga lloji i aktivitetit te kryer ato jane brenda limiteve te vendosura nga shtetet e BE.

#### **9.4.8 Administrimi i mbjetejeve urbane**

Mbetjet urbane te gjeneruara nga aktiviteti i kryer si dhe ai jetesor i punetoreve do te grumbullohen e vecohen dhe me vone do te transportohen drejt grumbullimit te mbetjeve urbane.

### **10. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR**

Projekti i propozuar nuk do kete ndikime negative ne mjedisin nderkufitar. Zona e Projektit ndodhet ne brendesi te vendit, dhe largesia nga ujerat nderkombetare eshte tejet e konsiderueshme. Sikurse eshte theksuar edhe me lart, ndikimi ne mjedis eshte shume i vogel dhe ne brendesi te ujerave territoriale shqiptare pa asnje ndikim ne ujerat nderkombetare.

Projektet qe do te ndertohen, nuk kane karakter nderkufitar. Keto projekte do te shtrihen vetem ne siperfaqen e kufizuar nga kordinatat qe jane dhene ne tabelen e kordinatave duke mos kaluar pertej ketyre kordinatave.

### **11. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Objekti i ketij raporti te vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis eshte vleresimi ne menyre konkrete i impakteve mjedisore te projektit:

Ne matricat e vleresimit te ndikimit ne mjedis te paraqitura me sipër, ne menyre te permbledhur jane paraqitur efektet negative dhe positive te zbatimit te komponenteve te projektit. Aktiviteti i ndertimit dhe shfrytezimit shoqerohet me shkarkime minimale te elementeve ndotes ne mjedis. Niveli i ndotjes ne ajër, ujë dhe tokë do të jete i paperfillshëm, por pavarësisht pritshmërisë, investitori do bëjë monitorimet e nevojshme dhe do të zbatojë masat zbutëse përkatëse. Ndikimet kryesore të rëndësishme negative do të dalin nga trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta por për këto do të merren masat përkatëse zbutëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme negative janë brenda kufinjve ligjerisht të pranueshem nese zbatohen masat e propozuara Ne këtë rast, përfitimet e këtij projekti do të jene shumë më të mëdha sesa ndikimet e mundshme negative.

#### **KONKLUZIONE**

1. Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones. Ndikime minimale do te kete vetem ne ndryshimin e peizazhit te siperfaqesku do te ndertohet dhe ku do te kalojne makinat qe do te siellin lenden e pare.
2. Procesi teknologjik ndertimit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ne procesin e ndertimit parashikohen te perdoren ujra. Këto ujera nuk kanë elemente qe mund të kontaminojnë mjedisin uJOR prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.
3. Perreth perimetrit te objektit i cili do te zhvillohet do te ndertohen kanalet drenazhues per ujerat atmosferike ne menyre qe te shmanget fenomeni i erozionit.
4. Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
5. Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere. Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit, behet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa gjithashtu dhe gjate vendosjes se gureve uje ndotet pak duke ngritur larte reren po pasiqetesohet uje kthehet ne gjendjen e meparshme, punetoret paisen me mjete mbrojtese ne pune si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
6. Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
7. Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.
8. Furnizimi me uje te pijshem do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike
9. Shkarkimi i ujrave te ndotur do te behet ne piken e miratuar nga Ndermarrja Ujesjelles Kanalizime



	Emertimi Dokumentit:	RAPORT VNM	Page:	65 of 65
--	-------------------------	------------	-------	----------

10. Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera kulturore , dhe ndryshimet e saj nuk do te ndikojne negativisht.
11. Per nje pune sa me optimale do te zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e drejtuesit e makinerive do njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes

Ne perfundim mund te themi se implementimi i projektit ne studim do te kete ndikim te drejtperdrejte ne mjedisin e zones por ky ndikim do te jete vetem gjate fazes se ndertimit dhe nuk akumulohet ne mjediset perreth.

Ndikimi ne mjedi do te jete i perkohshem dhe ne nivele te uleta dhe pas perfundimit te projektit do te kemi nje peisazh me te rregullt dhe me te paster.

**Rekomandohet:**

- ✓ Gjatë fazës së implementimit të projektit duhet të zbatohen me rigorozitet Planet e Manaxhimit dhe Monitorimit të projektit
- ✓ Te mundësohet shmangia e gjenerimit te mbetjeve dhe kur kjo nuk është e mundur, perzgjedhja e metodave sa me eficente per menaxhimin e tyre dhe seleksionimin e tyre.
- ✓ Të kryhet rehabilitimi i zonës pas zbatimit konkret te projektit dhe të tregohet kujdes që të shmanget degradimi i mjedisit natyror te zones perreth.
- ✓ Të merren të gjitha masat e pershtatshme per te parandaluar aksidentet rrugore dhe për të kufizuar pasojat e tyre.
- ✓ Të realizohet monitorimi i vazhdueshem i treguesve mjedisor per te shmatur cdo tejkallim te normave te shkarkimit per kete veprimtari (është pjese e listes se normave te shkarkimeve ne ujerat urbane prandaj duhet te konsultohen me institucionet pergjegjese).
- ✓ Të respektohet kodit i punes si dhe rregulloret e brendshme te vete veprimtarise.

**Eksperte Vleresimi Ndikimi ne Mjedis  
Ing.Roana TURTULLI**